# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5811
E mërkurë, 26 qershor 2019
çmimi 0.40 €


## Edhe për tre muaj vazhdon afati për legalizimin e armëve

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", VISAR YMERI FAQE 4-5



# Protagonizmi i Thaçit dhe Haradinajt në dialog po e dëmton Kosovën

Anëtari i Delegacionit Shtetëror të Kosovës për bisedime me Serbinë, Visar Ymeri, ka kritikuar për protagonizëm në procesin e dialogut me Serbinë presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD) ka deklaruar se kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën dhe nuk duhet të vazhdojë e tillë. Ymeri ka thënë se takimet e mëhershme të presidentit Thaçi larg syve të publikut dhe tani këto të përfaqësuesve të kryeministrit Haradinaj nuk janë të pranueshme dhe nuk i shërbejnë interesit të përgjithshëm. Duke folur për mocionin e mosbesimit të qeverisë, Ymeri ka theksuar se janë rritur gjasat për suksesin e një mocioni të tillë

## OPINION

ELITAT SHQIPTARE GJITHNJË NË SHËNJESTËR F. 11



Nga Jakup KRASNIQI

NJOHJA E PAVARËSISË DHE PRANIMI I KRIMIT TË GJENOCIDIT F. 11



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

## AKTUALE

QEVERIA TËRHEQ PROJEKTLIGJIN PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE F. 5

## EKONOMI

MONOPOLI NË HOMOLOGIM, PËRPLAS LEKAJN ME DEPUTETËT F.9

PUNËTORËT E KEK-ut KËRKOJNË RISHIKIMIN E LIGJIT PËR PAGA F.9

## KULTURË

DHEMBJA INDIVIDUALE E PËRBOTSHME F. 24



RESMIJE KRYEZIU

## SPORT

TRI MEDALJE NË LOJËRAT EVROPIANE, SUKSES I MADH PËR KOSOVËN F. 16

# Norvegjia premton mbështetje për liberalizimin e vizave

FAQE 3

Republika e Kosovës do ta ketë mbështetjen e Norvegjisë për liberalizimin e vizave dhe për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Kështu ka deklaruar të martën në Prishtinë ministrja e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, Ine Eriksen Soreide, në një konferencë të përbashkët për medie me ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacollin. Ministrja norvegjeze ka vlerësuar se procesi euroatlantik i Kosovës kërkon kohë, lidership të fuqishëm dhe koordinim më të madh në mes të partive politike



# KOMF-i, apel Kuvendit: Miratojeni Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve

FAQE 3




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Përplasje fizike mes protestuesve dhe policëve në Kukës

TIRANË, 25 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama të martën në orët e mbrëmjes ndodhej në Kukës, ku është dashur të mbajë fushatë elektorale në bashkitë e këtij qarku.
Ndërsa Rama është nisur drejt Kukësit, ka ndodhur një përleshje mes protestuesve dhe policisë. Forcat e policisë kanë ngritur kordon policor për të ndaluar simpatizantët e PD-së. Protestuesit në përleshje e sipër kanë thyer kordonin policor. Ata kanë thirrur në kor "Rama ik".
Rama është pritur me protesta thuajse në çdo bashki ku ka shkuar për fushatë elektorale.
Duke shmangur për pak orë tensionet dhe përplasjet që priteshin në Kukës, shefi i qeverisë është ndalur në Bashkinë e Tropojës, zonën e njohur si "shtëpia" e rivalit të tij historik Sali Berisha.
"Shtabi im elektoral kishte lënë vetëm Kukësin dhe unë i thash pa Tropojën nuk shkoj në Kukës. Dhe erdha në Tropojë, se besoj se edhe këtu si në shumë vende të tjera ku ne kemi drejtuar bashki, ndërsa këtu bashkia është drejtuar nga një kryebashkiak i djathtë, janë veprat që flasin më shumë sesa fjalët", tha Rama.
Kryeministri s'kishte si ta linte pa sulmuar Berishën dhe e goditi pikërisht te lejet për HEC-e në Valbonë, duke thënë se i duket e paimagjinueshme si një bir i kësaj toke i dha ato 11 leje.



# Meta thotë se më 30 qershor nuk ka zgjedhje të ligjshme

**Pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta tha se zgjedhje më 30 qershor ligjërisht nuk ka e nuk do të ketë dhe se vetëm Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vlefshmërinë e dekretit të presidentit të Republikës**



TIRANË, 25 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta tha të martën se zgjedhje më 30 qershor ligjërisht nuk ka e nuk do të ketë. Në një dalje publike pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor të hënën, kreu i Shtetit tha se ky vendim "ka të bëjë vetëm me marrëdhënien e partisë ankuese, aleate e Partisë Socialiste dhe organizatës socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që kanë vendosur të zhvillojnë një proces të paligjshëm më 30 qershor".
Ishte Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), e cila vuri në lëvizje Kolegjin, pasi më parë i kishte kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të çregjistrohej nga pjesëmarrja në zgjedhjet vendore, duke qenë se kreu i Shtetit kishte vendosur anulimin e 30 qershorit. Por KQZ-ja e kishte rrëzuar këtë kërkesë. Duke njohur si të drejtë, vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me kërkesën e Partisë së Unitetit Kombëtar, Kolegji praktikisht ka njohur 30 qershorin si datën e zhvillimin të zgjedhjeve vendore, ka njoftuar voa.
Por për presidentin Meta "institucioni i presidentit të Republikës nuk është thirrur nga kjo gjykatë zgjedhore si palë në proces, e për rrjedhojë vendimi i marrë nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik, qoftë për dekretin, ashtu edhe për anulimin e datës së zgjedhjeve. Në këtë proces, nënvizoi ai, Kolegji Zgjedhor nuk mund të shqyrtonte aspak vlefshmërinë kushtetuese të dekretit të presidentit të Republikës, pasi një tagër të tillë nuk ia njeh Kushtetuta".
Meta tha se sipas tij "vendimi i djeshëm i marrë nga Kolegji Zgjedhor është një truk procedural për të justifikuar politikisht paligjshmërinë e veprimtarisë së organizatës socialiste në KQZ-së dhe është një përpjekje e dëshpëruar për të ndërtuar një operacion propagandistik brenda dhe jashtë vendit për të anatemuar indirekt vendimin e kreut të Shtetit, por kurrsesi, ky është një operacion i dështuar pasi nuk prek aspak vlefshmërinë e dekretit të presidentit të Republikës", u shpreh presidenti, sipas të cilit vendimi i Kolegjit, "është i orkestruar dhe i paralajmëruar prej kohësh, është marrë në kushtet e presionit dhe shantazhit politik të mazhorancës".
Sipas Metës, vendi "është në një situatë paradoksale ku, presidenti i Republikës në zbatim të Kushtetutës ka anuluar me dekret një proces zgjedhor monist, që ishte planifikuar për t'u mbajtur më 30 qershor, ndërkohë që mazhoranca dhe organizata socialiste e KQZ-së, në paligjshmëri të plotë, vijojnë "teatrin" për të zhvilluar një proces votimesh që tashmë ligjërisht nuk ekziston në Republikën e Shqipërisë". Presidenti theksoi dhe një herë se "vetëm Gjykata Kushtetuese, dhe vetëm ajo, mund të shqyrtojë vlefshmërinë e dekretit të presidentit të Republikës", ndërsa shtoi se "ky akt është në fuqi dhe i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë në Republikën e Shqipërisë".
Shumica e majtë e ka konsideruar që në fillim si "të pavlefshëm" dekretin e presidentit Meta dhe vijon fushatën e saj elektorale, ndërkohë që opozita e cila i ka bojkotuar zgjedhjet vendore, këmbëngul duke deklaruar se nuk do të lejojë zhvillimin e tyre. Javën e shkuar në shumë prej qyteteve ku bashkitë drejtohen nga përfaqësuesit e opozitës, mbështetësit e saj u mblodhën para komisioneve zgjedhore zonale. Në disa raste pati dhe përplasje të dhunshme me policinë, e mbështetësit e opozitës mundën dhe të hyjnë brenda mjediseve të komisioneve duke marrë e shkatërruar materialet zgjedhore.
Komuniteti ndërkombëtar ka vijuar me thirrjet për qetësi dhe shmangien e akteve të dhunës. Të hënën ministri i Jashtëm italian Enzo Moavero Milanesi, pati biseda të veçanta telefonike me kryeministrin Edi Rama dhe kreun e opozitës Lulzim Basha, ku ai theksoi ndër të tjera se "duhet garantuar siguria dhe korrektësia e procesit zgjedhor".
Por presidenti Ilir Meta u shpreh të martën se "nuk kam anuluar zgjedhjet as në Itali, e as në Amerikë apo Kinë. Në Republikën e Shqipërisë, i vetmi institucion që vendos datën e zgjedhjeve është presidenti".

## Stoltenbergu: Shpresoj që deri në dhjetor Maqedonia e Veriut do të anëtarësohet në NATO

Bruksel, 25 qershor - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg shfaqi shpresën se procesi i ratifikimit të protokollit për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut, do të përmbyllet deri në dhjetor të këtij viti, në mënyrë që vendi të mund të bëhet anëtare fuqiplotë e NATO-s, gjatë samitit të ardhshëm në Londër.
"Ratifikimi i protokolleve nga ana e vendeve anëtare të NATO-s po zhvillohet shumë shpejt. Për përfundimin e një procesi të tillë, si në rastin e Malit të Zi, janë dashur një vit. Nuk më përket mua të flas për shpejtësinë me të cilën ratifikohet protokolli, mirëpo do të ishte shumë mirë që procesi të përfundojë deri në dhjetor kur do të mblidhen udhëheqësit e NATO-s në Londër", tha Stoltenbergu.
Maqedonia e Veriut përshpejtoi anëtarësimin në NATO, pas zhbllokimit të procesit nga ana e Greqisë, e cila nuk pranonte të hapë rrugën për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me emrin.
Marrëveshja historike mes dy vendeve u arrit më 2018, dhe parlamentet e të dyja vendeve e miratuan atë duke mundësuar ndryshimin e emrit, nga Maqedoni- në Maqedoni e Veriut.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ministrja e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, Ine Eriksen Soreide, ka qëndruar për vizitë në Republikën e Kosovës

# Norvegjia premton mbështetje për liberalizimin e vizave

Republika e Kosovës do ta ketë mbështetjen e Norvegjisë për liberalizimin e vizave dhe për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Kështu ka deklaruar të martën në Prishtinë ministrja e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, Ine Eriksen Soreide, në një konferencë të përbashkët për medie me ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. Ministrja norvegjeze ka vlerësuar se procesi euroatlantik i Kosovës kërkon kohë, lidership të fuqishëm dhe koordinim më të madh në mes të partive politike



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 25 qershor** - Ministrja e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Ine Eriksen Soreide, ka thënë të martën në Prishtinë se shteti norvegjez e përkrah integrimin euroatlantik të Kosovës. Mirëpo ajo ka thënë se ky proces kërkon shumë kohë, lidership të fuqishëm dhe koordinim më të madh në mes të partive politike. Sidoqoftë, ajo ka premtuar përkrahjen e Norvegjisë për liberalizimin e vizave dhe për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. "Ne kemi ngritur sistemin tonë për mbështetjen e Ballkanit Perëndimor dhe Kosova është mbështetur me shtatë milionë euro. Prioritete kyçe janë sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, procesi i dialogut me Serbinë dhe bashkëpunimi në zhvillimin ekonomik dhe rajonal. Ne e mirëpresim bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe përpiqemi që ta mbështesim sa më shumë. Investimeve në Kosovë besoj se është shans i mirë që të ndodhin si dhe është e rëndësishme të keni tregti të lirë. Norvegjia është e gatshme për ta mbështetur Kosovën në procesin e integrimeve euroatlantike dhe proceset e tjera", ka deklaruar ministrja norvegjeze në një konferencë të përbashkët për medie me zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli.

Ministrja Ine Eriksen Soreide ka shprehur përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. "Ne kemi raporte shumë të mira dhe jemi të interesuar që marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve të thellohen", ka theksuar ajo.

Ndërsa zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka shprehur mirënjohje ministres Ine Eriksen Soreide dhe institucioneve dhe popullit të Norvegjisë për përkrahjen e vazhdueshme që i kanë dhënë Kosovës. "Norvegjia ka qëndruar pranë nesh në kohët më të vështira, për rindërtimin e vendit tonë, për ruajtjen e paqes si dhe është ndër vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës", ka deklaruar ministri Pacolli. Ai ka treguar se gjatë takimit me ministren Soreide ka biseduar për rrugëtimin e Kosovës drejt integrimit evropian, me ç'rast ka thënë se Norvegjia ka një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. "E kam njoftuar ministren Soreide se Kosova ka përmbushur të gjitha kushtet e vendosura nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave dhe presim që qytetarët tanë të lëvizin lirshëm brenda një periudhe të shkurtër kohore", është shprehur Pacolli.

Ai ka shprehur përkushtimin e Kosovës për kultivimin e fqinjësisë së mirë dhe për zgjidhjen e çështjeve me dialog. "Në këtë drejtim dialogu ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë nuk ka alternativë dhe vetëm në mënyrë të barabartë si dy shtete sovrane dhe me respekt të ndërsjellë mund t'i normalizojmë marrëdhëniet", ka theksuar Pacolli.

Ministrja e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Ine Eriksen Soreide, është pritur në takim edhe nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike, procesin integrues dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar ministren Soreide për përparimin e Kosovës, prioritetet e qeverisë në zhvillimin ekonomik, për hapjen e vendeve të reja të punës, për avancimin në agjendën e reformave evropiane dhe në sundimin e rendit. Me këtë rast, Haradinaj e ka falënderuar ministren për mbështetjen e vazhdueshme që Norvegjia ia ka dhënë Kosovës në proceset e shtetndërtimit. Ai ka thënë se qeveria është e përkushtuar për fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale, bashkëpunimin në fushën e sigurisë, ekonomisë, edukimit dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët. "Norvegjia ka ndihmuar në avancimin dhe zhvillimin demokratik të shumë proceseve në Kosovë dhe për këtë u jemi mirënjohës", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ai ka kërkuar mbështetjen e mëtejme të Norvegjisë për procesin e konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të vendit. Kryeministri Haradinaj, po ashtu, ka theksuar se Kosova është e përkushtuar për një dialog të kornizuar dhe përmbajtjesor me Serbinë që çon në një marrëveshje finale ligjërisht të obligueshme në kufijtë ekzistues dhe me njohje reciproke mes dy vendeve. Ndërkaq ministrja e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, Ine Eriksen Soreide, ka ritheksuar gatishmërinë e Norvegjisë për mbështetjen e Kosovës në procesin e integrimeve euroatlantike dhe proceset e tjera. Një ditë më parë ministrja norvegjeze është takuar edhe me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi.



## Javën e ardhshme mbahet seanca e jashtëzakonshme për Luginën

**Prishtinë, 25 qershor (ER)** - Kuvendi i Republikës së Kosovës javën e ardhshme (të hënën) në orën 11:00 pritet të mbajë seancë të jashtëzakonshme për Luginën e Preshevës. Kjo është bërë me dije të martën në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, si dhe Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ku është diskutuar lidhur me kërkesat e Këshillit Kombëtar Shqiptar nga vizita e përbashkët e realizuar në Luginë të Preshevës. Në këtë seancë të jashtëzakonshme Kuvendit pritet të merret një vendim obligues për ta ndihmuar Luginën e Preshevës.



Flet për "Epokën e re", Visar Ymeri

# Protagonizmi i Thaçit dhe Haradina




**Anëtari i Delegacionit Shtetëror të Kosovës për bisedime me Serbinë, Visar Ymeri, ka kritikuar për protagonizëm në procesin e dialogut me Serbinë presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD) ka deklaruar se kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën dhe nuk duhet të vazhdojë e tillë. Ymeri ka thënë se takimet e mëhershme të presidentit Thaçi larg syve të publikut dhe tani këto të përfaqësuesve të kryeministrit Haradinaj nuk janë të pranueshme dhe nuk i shërbejnë interesit të përgjithshëm. Duke folur për mocionin e mosbesimit të qeverisë, Ymeri ka theksuar se janë rritur gjasat për suksesin e një mocioni të tillë**

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Anëtari i Delegacionit Shtetëror i Kosovës për Bisedime me Serbinë, Visar Ymeri, ka bërë me dije se ky delegacion nuk ka qenë fare i përfshirë as në takimin e Berlinit dhe as në përgatitjet e takimit të Parisit, i cili ka dështuar të mbahet. Ai ka kritikuar për protagonizëm presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj në procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD) ka thënë se kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën dhe duhet të ndalet. "Ndërsymja protagoniste ka qenë tejet e dëmshme në secilën nevojë e secilin aktivitet të politikës së jashtme të Kosovës. Këtë protagonizëm e personalizim të politikës e kemi parë të shquhet shumë nga presidenti Thaçi (UNESCO, takimet me Vuçiqin e idetë që dilnin nga këto). Në ndërkohë, edhe nga kreu i Qeverisë, Haradinaj. Kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën. Prandaj edhe nuk duhet vazhduar", ka thënë Ymeri. Ai ka bërë me dije se dialogu dhe marrëveshja me Serbinë janë çështje tejet të ndjeshme dhe të rëndësishme për të ardhmen e Republikës së Kosovës.

Sipas tij, këto çështje nuk duhet të diskutohen në takime të fshehta. "Takimet e mëhershme të presidentit Thaçi, për të cilat dëgjonim vetëm në formën e ideve të diskutuara dhe këto tashmë të përfaqësuesve të kryeministrit, nuk janë të pranueshme, të dobishme dhe të shëndosha. Përfaqësimi politik, e veçanërisht ai institucional në Kosovë, duhet ta kuptojë demokracinë jo si fjalë boshe dhe as vetëm si procedurë, por si sistem kompleks dhe legjitim i vendimmarrjes", është shprehur ai, duke shtuar se takimet larg syve të publikut janë e kundërta e demokracisë dhe nuk i shërbejnë interesit të përgjithshëm.

Deputeti i PSD-së ka folur edhe për mocionin e opozitës ndaj qeverisë. "Mendoj se po rriten gjasat për suksesin e një mocioni të tillë. Për ne është tejet e rëndësishme jo vetëm si arrijmë deri te mocioni, por çfarë ndodh pas tij (pas zgjedhjeve)!? A do të ketë ndryshim pas zgjedhjeve? Apo vetëm përsëritje të së njëjtës mendësi e cilësi të politikëbërjes dhe vendimmarrjes", ka deklaruar ai.

**"Epoka e re":** *Z. Ymeri, mbajtja e takimit të Parisit, i cili shihej si një rast i mirë për zhbllokimin e dialogut Kosovë - Serbi, dështoi. Si anëtar i ekipit negociator, a keni ndonjë informatë pse dështoi ky takim?*

**Ymeri:** Delegacioni shtetëror nuk ka qenë fare i përfshirë as në takimin e Berlinit e as në përgatitjet e atij të Parisit. Nuk duhet harruar se si Rezoluta, ashtu edhe ligji që e themelojnë dhe e rregullojnë punën e kompetencat e dialogut, kanë paraparë një dialog tjetër fare. Për dallim nga dialogu i zhvilluar në Bruksel nga viti 2011, kjo fazë e dialogut e drejtuar nga delegacioni shtetëror ka pasur qëllim dhe strategji të qartë: dialog për njohje (e jo dialog pa krye), dialog me parime dhe jo i hapur ndaj çdo gjëje. Për dallim prej dialogut të drejtuar nga presidenti Thaçi, dialogu i udhëhequr nga delegacioni shtetëror ka qenë i udhëhequr nga parimi i transparencës dhe legjitimitetit demokratik dhe koncensual, si dhe në kuadër të parimeve bazë kushtetuese të Republikës së Kosovës: të sovranitetit shtetëror, integritetit territorial dhe barazisë së qytetarëve. Ndërsymja protagoniste ka qenë tejet e dëmshme në secilën nevojë e secilin aktivitet të politikës së jashtme të Kosovës. Këtë protagonizëm e personalizim të politikës e kemi parë të shquhet shumë nga presidenti Thaçi (UNESCO, takimet me Vuçiqin e idetë që dilnin nga këto). Në ndërkohë, edhe nga kreu i qeverisë, Haradinaj. Kjo qasje e ka dëmtuar Kosovën. Prandaj nuk duhet vazhduar.

# jt në dialog po e dëmton Kosovën



**"Epoka e re":** *Para disa ditësh, pa ndonjë paralajmërim, në Berlin janë takuar disa zyrtarë të Qeverisë së Kosovës dhe të Serbisë. Keni pasur ftesë si ekipi negociator për këtë takim dhe a jeni informuar se çfarë është diskutuar në këtë takim?*

**Ymeri:** Dialogu me Serbinë, marrëveshja me të (për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen), përmbajtja e saj, janë çështje tejet të ndjeshme dhe të rëndësishme për të ardhmen e Republikës së Kosovës, Si të tilla, këto duhet të jenë rezultat i diskutimit të hapur të brendshëm politik dhe shoqëror. Aspak e asnjëherë tema të takimeve të fshehta. Takimet e mëhershme të presidentit Thaçi, për të cilat dëgjonim vetëm në formën e ideve të diskutuara dhe këto tashmë të përfaqësuesve të kryeministrit, nuk janë të pranueshme, të dobishme dhe të shëndosha. Përfaqësimi politik, e veçanërisht ai institucional në Kosovë, duhet ta kuptojë demokracinë jo si fjalë boshe dhe as vetëm si procedurë, por si sistem kompleks dhe legjitim i vendimmarrjes. Debati i hapur e veprimi, sipas tij, është thelbi i një vendimmarrje demokratike. Takimet e pajtimet larg syve të publikut janë e kundërta e demokracisë dhe nuk i shërbejnë interesit të përgjithshëm.

**"Epoka e re":** *Ndonëse partnerët ndërkombëtarë të Kosovës vazhdojnë të insistojnë që marrëveshja historike në mes të dy shteteve të arrihet këtë vit, zhbllokimi i këtij procesi duket larg. Si e shihni vazhdimin e këtij procesi?*

**Ymeri:** Gjëja më e rëndësishme është t'i bashkojmë përfaqësuesit politikë e shoqërorë në Kosovë në mënyrë që ta kemi një qëndrim të qartë për synimet e kërkesat tona në dialog si dhe qëllimin që duam ta arrijmë. Kemi humbur shumë kohë në këtë drejtim. Platforma shtetërore e miratuar në Kuvendin e Republikës e bën pikërisht këtë. Do të duhej që të arrijmë qëndrim konsensual rreth saj. Vetëm atëherë do ta kemi më të lehtë në dialog e do të jemi më të suksesshëm në mbrojtjen e interesave të Kosovës. Bllokimi i procesit të dialogut ka ardhur si rezultat i kushteve nga Serbia. Uniteti ynë i brendshëm na bënë më cilësorë dhe më të fortë në kërkesat tona jashtë.

**"Epoka e re":** *Tashmë opozita i ka mbledhur të gjitha nënshkrimet për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Sa janë gjasat që përmes këtij mocioni të rrëzohet qeveria?*

**Ymeri:** Partia Socialdemokrate ka qenë e para që i ka dorëzuar nënshkrimet e deputetëve të vet për një mocion mosbesimi ndaj qeverisë. Që prej atëherë ne kemi qenë në përkrahje për një mocion të tillë, gjithnjë të vetëdijshëm se në Kuvend atëbotë, si edhe sot, nuk i kemi 61 deputetët e nevojshëm për votimin e mocionit. Mendoj se po rriten gjasat për suksesin e një mocioni të tillë. Për ne është tejet e rëndësishme jo vetëm si arrijmë deri te mocioni, por çfarë ndodh pas tij (pas zgjedhjeve)!? A do të ketë ndryshim pas zgjedhjeve? Apo vetëm përsëritje të së njëjtës mendësi e cilësi të politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Ju kujtohet se VLAN-i rezultoi me kalimin e LDK-së në anën e PDK-së, për pushtetin vetëm si pushtet. Njëlloj me VAN-in, kur AAK doli në anën e PDK-së. Që të dy këto qeveri jo vetëm e mbajtën PDK-në në pushtet, por edhe e vazhduan në mënyra dhe me ritëm të ndryshëm, qeverisjen neoliberale, konservatore dhe të korruptuar. Dy çështje janë pothuajse sot të domosdoshme që të ndryshojë pozitivisht gjendja aktuale në Kosovë. E para është që PDK-ja të shkojë në opozitë. E dyta që qeveria e ardhshme e Republikës së Kosovës të ketë politika sociale e zhvillimore dhe kapacitete demokratike, si dhe të jetë e pakompromis në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përndryshe, nuk do të kemi kurrfarë ndryshimi në raport me shtetin e kapur, procesin e domosdoshëm të vetingut në sektorin e sundimit të ligjit, në orientimin e kapaciteteve ekonomike në funksion të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies shoqërore si dhe në demokratizimin e vendit.

**"Epoka e re":** *Shumë analistë thonë se në vjeshtë mund t'i organizohen zgjedhjet e reja. A ka menduar PSD-ja për ndonjë koalicion parazgjedhor apo do të garojë e vetme?*

**Ymeri:** Jemi të gatshëm për zgjedhje. Fuqia e PSD-së në terren po rritet vazhdimisht krahas shtimit e konsolidimit të strukturave tona nëpër vendbanimet e Kosovës. Performanca e grupit tonë parlamentar është e shkëlqyer dhe e ka përcaktuar një tjetër mënyrë të politikëbërjes në Kosovë duke u përqendruar te interesat e qytetarëve dhe të shtetit përtej kacafytjeve e inateve personale dhe klanore. Ne jemi të vendosur që Republikës së Kosovës i duhet një ndryshim cilësor politik e institucional që ua kthen institucioneve integritetin, shton kapacitetet ekonomisë, rrit mirëqenien e qytetarëve, mbron të drejtat e punëtorëve, përbashkon përmes barazisë qytetarët dhe ia kthen sovranitetin popullit. Në këtë drejtim shkojnë bashkëpunimet tona politike dhe elektorale. Kjo është e mundshme. Kosovës i duhen institucione nga të cilat është ç'rrënjosur mendësia e deritashme politike që publiken e kanë parë si pronë e paprivatizuar dhe për privatizim. Prandaj konsiderojmë se ky është moment tejet i rëndësishëm dhe tejet i mundshëm për ta bërë një ndryshim të tillë. Kosova ka nevojë për ç'rrënjosje të kriminalitetit dhe korrupsionit në strukturat e pushtetit, siç edhe ka nevojë për më shumë punësim dhe barazi sociale. Për shtet ligjor dhe shtet të së drejtës. Këtë e bën një qeverisje sociale dhe demokratike. Për këtë edhe angazhohemi e do të angazhohemi me partitë që e duan një ndryshim të tillë dhe të cilat kanë kredibilitetin për një gjë të tillë.

# Qeveria tërheq Projektligjin për financimin e subjekteve politike

**PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER)** - Qeveria në mbledhjen e së martës ka aprovuar propozimin për t'iu drejtuar Kuvendit të Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike. Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka miratuar memorandumin e mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës.

Qëllimi i këtij memorandumi është arritja e objektivave të përbashkëta dhe konfirmimi i bashkëpunimit për planifikimin dhe zhvillimin e përbashkët dhe të njëkohshëm të projektit "Prishtina e Re" i cili ngërthen në vete ndërtimin e kompleksit të rezidencave qeveritare dhe qendrës administrative të kryeqytetit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Miratimin e qeverisë e ka marrë edhe plani i veprimit për garën republikane për kreativitet kulturor dhe mendim kritik për vitin 2019. Kabineti qeveritar ka aprovuar edhe vendimin për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për personat e zhdukur. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar nismën për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.

Është aprovuar edhe nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), për grantin e financimit të projektit për mënjanimin e ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore - Faza VI. Granti financiar për këtë fazë të projektit është 9 milionë e 500 mijë euro.

Qeveria e Kosovës në këtë mbledhje ka bërë rialokimin e mjeteve në shumën prej 1 milion e 501 mijë e 445 eurove në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në projektin e bashkëfinancimit me donatorë për skemën e granteve të bazuara në performancën komunale në 30 projekte kapitale.



# IKD-ja: Sistemi i drejtësisë ka dështuar për trajtimin e rasteve e të lëndëve të shënjestruara

EPOKA E RE Qendresa RAMA




PRISHTINË, 25 QERSHOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, ka publikuar të martën raportin analitik me temë "Dështimet në rastet e shënjestruara".

Ky raport përfshin gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet lidhur me procesin dhe trajtimin e rasteve të shënjestruara nga sistemi i drejtësisë që nga fillimi i këtij procesi (dhjetor 2015) e deri në maj 2019.

Drejtori ekzekutiv i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka thënë se sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor kanë dështuar për trajtimin e rasteve të shënjestruara. Sipas Miftarajt, vetë procesi i shënjestrimit nuk ka qenë në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të miratuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), pasi janë shënjestruar raste të cilat nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me këto PSV. Ai thënë se qëllimi i shënjestrimit të rasteve të krimeve të rënda ka pasur për qëllim final konfiskimin e pasurive të përfituara përmes aktiviteteve kriminale gjë e cila nuk ka ndodhur pasi nuk ka asnjë rezultat në këtë drejtim.

Ndërkohë Medina Kadriu, hulumtuese në IKD, ka thënë se prej dhjetorit të vitit 2015 deri në qershor të këtij viti janë shënjestruar 51 raste, në të cilat janë përfshirë 372 persona. "Edhe përkundër faktit se shënjestrimi i rasteve kishte për qëllim trajtimin e këtyre rasteve me prioritet, nga monitorimi dhe hulumtimi i IKD-së rezulton se në mbi 90 për qind të rasteve të shënjestruara gjykatësit shkelin afatet ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale", ka theksuar Kadriu. Sipas saj, joefikasiteti në trajtimin e këtyre lëndëve dështmohet nga trajtimi i tyre prej dhjetorit 2015 deri në fund të muajit maj 2019, në të cilën periudhë rezulton se vetëm 39 për qind e rasteve apo 15 lëndë kanë përfunduar me aktgjykim përfundimtar, ndërsa 61 për qind apo 23 lëndë të tjera janë ende në proces në shkallë të ndryshme gjyqësore. "Nga 23 rastet që janë në proces, (10) prej tyre janë duke u trajtuar në shkallë të parë, nëntë (9) prej tyre kanë përfunduar në shkallë të parë, por gjenden në procedurë ankimore, ndërsa katër (4) lëndë të tjera janë kthyer në rigjykim", ka deklaruar Kadriu.

Ndërsa Leotrim Gashi, hulumtues në IKD, ka prezantuar pjesën e procedimit të këtyre rasteve të shënjestruara në sistemin gjyqësor. "Karakteristikë tjetër në trajtimin e këtyre rasteve përbën fakti se shumica e lëndëve të shënjestruara janë duke dështuar që të përfundojnë me aktgjykime dënuese dhe konfiskim të pasurisë. Nga 15 rastet e gjykuara me aktgjykim përfundimtar, ku janë përfshirë 48 persona të akuzuar, 34 persona apo 71 për qind të tyre janë liruar nga gjykatat, ndërsa 14 persona apo 29 për qind të tyre janë dënuar. Politika e dënimeve ndaj këtyre 14 personave nuk është adekuate dhe përmes saj nuk arrihet qëllimi i dënimit. Nëntë prej të akuzuarve janë dënuar me burgim efektiv, ndërsa pesë të akuzuar janë dënuar me gjobë", ka thënë Gashi. Ai ka shtuar se profili i personave të akuzuar në këto raste dominohet nga profili i ulët dhe profili i mesëm, ndërsa ka pak të profilit të lartë. "Për më tepër, në këto 15 raste të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë nuk ka asnjë person që i takon profilit të lartë që është dënuar, të gjithë janë liruar", ka deklaruar Gashi.

Më tutje, Gashi ka theksuar se në të gjitha këto raste pasuria e konfiskuar është zero. "Ka raste kur ka pasur konfiskim të pasurisë në raport me mjetet e kryerjes së veprave penale, të cilat mjete në vetvete paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Por, në asnjë rast nuk kemi pasur konfiskim lidhur me veprat penale për të cilat personat e përfshirë në këto raste janë akuzuar apo janë dënuar", ka thënë ajo.

Në korrik të vitit 2014 KPK-ja kishte miratuar "Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional". Përmes tyre, institucionet që zbatojnë ligjin në Kosovë synonin që përmes koordinimit dhe bashkëpunimit reciprok të parandalonin, zbulonin, hetonin dhe gjykonin kryesit e veprave më të rënda penale, e që për qëllim final kishin sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar përmes veprave penale. Një vit pas KPK-së, KGJK, më 30 dhjetor 2015 kishte nxjerrë vendim me të cilin obligonte kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët e çështjeve që të gjitha rastet që vijnë nga prokuroria dhe kanë shenjën "LV" (Liberalizim i vizave), të trajtohen me prioritet absolut.

Prej dhjetorit 2015 deri në qershor 2019 janë shënjestruar 51 raste, ku prej tyre, 36 raste i takojnë natyrës korruptive, ku përfshihen 206 persona, ndërsa 15 raste të tjera, ku përfshihen 166 persona, i takojnë natyrës së krimit të organizuar apo gjithsejtë 372 persona.

Nga analiza e IKD-së rezulton se mekanizmi për shënjestrimin e rasteve të krimeve të rënda për liberalizimin e vizave vazhdimisht ka shkelur kriteret e përcaktuara në Procedurat Standarde të Veprimit me rastin e shënjestrimit të rasteve. Shumë lëndë të shënjestruara nuk i plotësojnë kriteret e PSV-ve, ndërsa shumë lëndë, të cilat i plotësojnë kriteret për shënjestrim, nuk janë shënjestruar.

# 400 anëtarë të SBAShK-ut nisin pushimin në bregdetin shqiptar



PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Këtë verë 400 anëtarë të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK) pushojnë në bregdetin shqiptar. Grupi i parë do t'i nisë pushimet më 26 qershor, për të vazhduar grupet e tjera sipas agjendës së përcaktuar nga komisioni për përgatitjen e pushimeve. "Duke vlerësuar e çmuar lart përkushtimin e punëtorëve të arsimit të Kosovës në edukimin e arsimimin e brezave, SBAShK-u vazhdon traditën e mirë të njohjes së këtij kontributi duke dërguar çdo verë një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të vet për pushime në bregdetin shqiptar. Në verën e 2019-s Këshilli Drejtues i SBAShK-ut, pasi ka analizuar në përpikëri mundësitë buxhetore, ka vendosur që në çdo 60 anëtarë të dërgojë një pushues në bregdetin shqiptar. Përzgjedhjen e pushuesve e kanë bërë shoqatat sindikale në çerdhe, shkolla fillore e të mesme, në njësitë akademike të universiteteve dhe të institucioneve të kulturës", është thënë në njoftimin e SBAShK-ut.

Sipas këtij njoftimi, të 400 pushuesit janë të ndarë në katër grupe me qëllim që organizimi të jetë sa më i mirë i pushimeve dhe aktiviteteve sindikale atje. "Grupi i parë me pushuesit nga Podujeva, Prishtina, Skenderaj, UP-ja, Qendra e Studentëve, Fushë-Kosova, Obiliqi dhe institucionet e kulturës e nisin këtë traditë të mirë të mërkurën, më 26 qershor, për të vazhduar ky aktivitet me pushuesit nga komunat e tjera sipas agjendës së përcaktuar nga komisioni për përgatitjen e pushimeve. Pushuesit gjatë qëndrimit në bregdetin shqiptar, përveç pushimit të merituar, do të zhvillojnë edhe aktivitete sindikale përmes tryezave dhe debateve për arritjet, sfidat dhe idetë e reja për angazhimin sindikal në vijim. Kryesia e SBAShK-ut dhe komisioni për pushime për hir të transparencës së plotë, me të përfunduar të këtij aktiviteti, do ta botojë në uebfaqen e saj (sbashk-rks.org) listën e plotë me të gjithë emrat e pushuesve që janë caktuar nga shkollat dhe njësitë akademike", është bërë me dije në njoftimin e SBAShK-ut.

# Edhe për tre muaj vazhdon afati për legalizimin e armëve

**Koordinatori Nacional i Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla të Lehta dhe të Eksplozivëve, njëherësh zëvendësministër i MPB-së, Izmi Zeka, ka thënë se qëllimi i këtij vendimi është që bashkërisht t'i inkurajojmë të gjithë qytetarët dhe bashkatdhetarët tanë që gjenden për pushime në Republikën e Kosovës për ta shfrytëzuar mundësinë për legalizimin e armëve. Zeka ka thënë se Kosova ka bërë përparim në kontrollin e armëve, mirëpo ende mbetet sfidë kontrollimi i armëve**




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) është mbajtur të martën një konferencë për media për vazhdimin e afatit për legalizim të armëve. Vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, respektivisht Qeverisë së Republikës së Kosovës për vazhdimin e fazës së dytë të kampanjës për legalizimin e armëve, do të zgjasë deri më 17 shtator.

Koordinatori Nacional i Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe të Eksplozivëve, njëherësh zëvendësministër i MPB-së, Izmi Zeka, ka thënë se qëllimi i këtij vendimi është që bashkërisht t'i inkurajonë të gjithë qytetarët dhe bashkatdhetarët tanë që gjenden për pushime në Republikën e Kosovës, për ta shfrytëzuar mundësinë për legalizimin e armëve.

Zëvendësministri Zeka vuri në dukje se Kosova ka bërë përparim në kontrollin e armëve, mirëpo ende mbetet sfidë kontrollimi i armëve.

Ai ka theksuar se përdorimi i armëve të vogla dhe të lehta paraqet një kërcënim për qytetarët dhe jetën e tyre. "Republika e Kosovës është në rrugën drejt procesit të integrimit evropian dhe ne kemi nevojë që bashkërisht të jemi më aktivë në fushën e zvogëlimit të armëve të paligjshme në vendin tonë, t'i legalizojmë ato dhe të krijojmë një siguri cilësore për qytetarët tanë", ka thënë. Zeka.

Përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, ka theksuar se posedimi i armëve të vogla në rajon dhe botë po e vë në rrezik sigurinë publike, zhvillimin ekonomik dhe po merr jetë. "Kosova është vend i sigurt me një shoqëri të sigurt dhe se mund të jetë model dhe pikë referente për të gjithë rajonin", ka thënë Suokko.

Ajo ka theksuar se fushata për legalizim të armëve mbështetet nga misioni i UNDP-së në Kosovë në partneritet me qeverinë gjermane (Zyrën për Punë të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë).

Ndërsa drejtori i Divizionit për Siguri Publike në Policinë e Republikës së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka theksuar se procesi për legalizimin e armëve ndikon në uljen e vrasjeve që është vepra më e rëndë penale. Ai ka treguar se janë konfiskuar armë edhe pse ky trend kohët e fundit ka rënë.

Në kampanjën e parë për legalizimin e armëve ka pasur rreth 1 428 kërkesa për legalizim, rreth 682 pëlqime të lëshuara dhe shtatë kërkesa për deaktivizim. Policia e Kosovës çdo vit konfiskon rreth 1 300 armë, respektivisht në vitin 2016 ka konfiskuar 1 292 armë, në vitin 2017 ka konfiskuar 1 211 armë, ndërsa në vitin 2018 ka konfiskuar 1 473 apo gjithsej 6 176 konfiskime dhe legalizime.

# KOMF-i, apel Kuvendit: Miratojeni Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Përfaqësuesit e koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF kanë mbajtur konferencë për media të martën përpara objektit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku i bën thirrje Kuvendit ta miratojë sa më parë Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Projektligji për mbrojtjen e fëmijëve tash e sa vite është iniciuar duke mos arritur të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. KOMF-i ka bërë me dije se gjendja e fëmijëve në Kosovë është e rëndë, prandaj ka kërkuar që Projektligji për mbrojtjen e fëmijëve të miratohet sa më shpejt në mënyrë që ta sigurojë mbrojtjen e fëmijëve.

Të dhënat e fundit flasin për një shkallë të varfërisë së fëmijëve prej 20.7 përqindësh. 10.7 për qind e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në punë, përderisa 6.8 për qind prej tyre punojnë në kushte të rrezikshme. 61.4 për qind e fëmijëve në Kosovë kanë deklaruar se kanë përjetuar dhunë fizike apo psikologjike gjatë muajit të fundit të intervistimit kur është bërë hulumtimi. Vetëm 10 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë qasje në shërbime cilësore shëndetësore, sociale dhe arsim. Raportet nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare flasin për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në sjellje që janë në kundërshtim me ligjin, përfshirë edhe dhunën, pasojat e së cilës në disa raste kanë qenë fatale për vetë fëmijët.

Duke pasur për bazë gjendjen e rëndë të fëmijëve në Kosovë, KOMF-i kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ta vendosë prioritet dhe të miratojë Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Projektligji për mbrojtjen e fëmijës ka për qëllim ta mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës.




Projektligji ka qëllim t'i garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të lartë të fëmijës si dhe ngritjen e sistemit të integruar dhe funksional të mbrojtjes së fëmijës për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Pas konferencës, koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF ka dorëzuar tek të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës dokumentin me kërkesën për miratimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

# Njohja e pavarësisë dhe pranimi i krimit të gjenocidit

*Çështja e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë është çështje politike që varet edhe nga vullneti i saj. Ndërsa pranimi i krimit të gjenocidit në Kosovë është çështje e drejtësisë dhe duhet t'i imponohet Serbisë*



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Me kërkesën e Serbisë, më 8 tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën (Rezoluta A/63/3, 8 tetor 2008) përmes së cilës kërkoi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendim lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Konkretisht, kësaj gjykate iu kërkua t'i përgjigjej pyetjes: "A është shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?"

Duke u mbështetur në argumentet e trajtuara dhe të ekspozuara në 121 paragrafë, më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli vendimin e vet se "akti i miratimit të deklaratës së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit e as Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, miratimi i kësaj deklarate nuk ka bërë shkeljen e asnjë rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare". (Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, paragrafi 73).

Përkundër kësaj, Serbia nuk e njeh pavarësinë e shtetit të Kosovës, sepse kjo është çështje politike që varet edhe nga vullneti i saj. Nuk ekziston asnjë instrument ndërkombëtar që e detyron Serbinë ta ndryshojë qëndrimin.

Një gjë të tillë pohoi edhe presidenti aktual i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ky ish-ministër i Informacionit të Serbisë së Sllobodan Milloshevïqit, që gjatë kohës së luftës kishte për funksion fshehjen e gjenocidit në Kosovë, deklaroi për "TV Pink" të Serbisë se "nëse nuk merr nga Kosova atë që ka në plan, nuk do ta njohin pavarësinë e Kosovës edhe sikur të gjithë amerikanët"! Prandaj, vetëm ata që dëshirojnë t'i falin tokën e Kosovës Serbisë mund të shpresojnë për arritjen e marrëveshjes me Serbinë e udhëhequr nga ata që përpiluan, ekzekutuan dhe fshehën krimin e gjenocidit në Kosovë.

Për dallim nga njohja e pavarësisë së Kosovës, si çështje politike, krimi i gjenocidit është çështje e drejtësisë dhe duhet t'i imponohet Serbisë!

Është e qartë se refuzimi i pranimit të përgjegjësisë shtetërore për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë është politikë konstante e këtij shteti. Madje edhe në kohën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, ministri i atëhershëm serb i Punëve të Jashtme, Goran Svillanoviq, refuzonte të jepeshin provat për gjenocidin në Kosovë, me arsyetimin se "nëse ju ndihmojmë ta dënoni Milloshevïqin për gjenocid, atëherë edhe shteti ynë do të dënohet për gjenocid nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe do të duhet t'i paguajmë miliarda dollarë dëmshpërblim... Ndërsa presidenti i atëhershëm serb Vojislav Koshtunica mbronte tezën se 'drejtësia dhe e vërteta e dëmtojnë stabilitetin në rajon dhe veprojnë kundër paqes'" (Florence Hartmann, Paix et châtiment, f. 118).

Mirëpo gjenocidi, si shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare, prek tërë komunitetin ndërkombëtar. Nëse arrijmë të ndriçojmë në përmasa ndërkombëtare gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe ta sigurojmë mbështetjen e forcave demokratike në botë, atëherë shteti serb do të jetë i detyruar t'i pranojë krimet e kryera dhe të japë llogari për planifikimin dhe zbatimin e gjenocidit në Kosovë.

# Bytyqi raporton para deputetëve për tekstet e reja shkollore

**PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER)** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, ka raportuar të martën në Komisionin Parlamentar për Arsim për procesin e zhvilluar në lidhje me tekstet e reja shkollore. Bytyqi ka thënë se kanë qenë të pritshme vështirësitë në këtë proces sepse, sipas tij, ky është projekti më i madh që është realizuar këto vite në MAShT. Ai ka theksuar se janë marrë të gjitha masat që procesi të shkojë si duhet, duke i respektuar të gjitha aktet ligjore në fuqi.



Ministri Bytyqi ka përmendur edhe Ligjin e ri për tekste shkollore, duke thënë se ky ligj nuk ka kaluar ende për arsye buxhetore, por ka theksuar se kjo nuk e ka penguar fare këtë proces. Duke folur për nevojën për tekste të reja shkollore, ministri Bytyqi ka përmendur mospërputhjen e teksteve me kurrikulën e re, si dhe gabime të shumta të cilat kanë pasur tekstet e vjetra.

Më tutje, ministri Bytyqi ka folur për të gjithë mbarëvajtjen dhe punën që është bërë që nga fillimi, si dhe për shpenzimet që janë bërë gjatë gjithë procesit, e që janë rreth 76 mijë euro në tërësi. Sa i përket cilësisë së teksteve, ministri Bytyqi ka thënë se përgjegjësinë e vlerësimit të tekstit e mbajnë recensentët, ndërsa MAShT-i ka obligim të kujdeset që procesi të shkojë deri në fund si duhet.

Ministri Bytyqi ka përmendur edhe vendimin e KEPShT-it që në listën përfundimtare të teksteve fituese të futen edhe tekstet që janë poentuar mbi 2.75, e që në listën preliminare kanë qenë vetëm ato që janë poentuar mbi 3. Megjithatë, ministri Bytyqi ka thënë se MAShT-i ka vendosur t'i pilotojë të gjitha tekstet shkollore dhe nëse vërehet se një tekst nuk është i përdorshëm për mësimdhënie, do të tërhiqet dhe recensentët do të përgjigjen sipas obligimeve të marra me kontratë.

## Shkolla "Pjetër Bogdani" pranon pajisje për klubet e mediave

**PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER)** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me udhëheqësin e projektit të arsimit fillor në GIZ, Boris Scharlowski (Zhvillimi i kapaciteteve në arsimin fillor në Kosovë) dhe drejtoreshën e Arsimit në Komunën e Prishtinës, Shpresa Shala, kanë vizituar Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Pjetër Bogdani" në Prishtinë, me ç'rast është bërë edhe dorëzimi i pajisjeve për klubet e mediave.

Shkolla "Pjetër Bogdani" është një nga 20 shkollat e përzgjedhura për projektin "Shkollat kampione", i cili fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve në shkollë dhe me pajisjen me materiale të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare. Pra, projekti synon zbatimin e qasjes së integruar për zhvillim të shkollës në shkollat e përzgjedhura dhe, po ashtu, synon ta forcojë rolin e të gjithë aktorëve në shkollë. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka falënderuar GIZ-in i cili vazhdimisht ka dhënë kontribut të madh në sistemin tonë arsimor dhe ka thënë se me këtë partner të rëndësishëm po vazhdojnë projektet e tjera të përbashkëta.



# Punëtorët e KEK-ut kërkojnë rishikimin e Ligjit për paga

Punëtorët e Sindikatës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës kanë protestuar të martën në Prishtinë, duke kërkuar respektimin e marrëveshjes kolektive në nivel të KEK-ut, dhënien e pagës jubilare, rivitalizimin e Termocentralit "Kosova A", rishikimin e Ligjit për paga dhe rritjen e shujtës së ushqimit




EPOKA E RE A. MAVRAJ

**Prishtinë, 25 qershor** - Sindikata e Re e Korporatës Energjetike të Kosovës ka protestuar të martën duke kërkuar marrëveshje kolektive në nivel të KEK-ut, dhënie të pagës jubilare në vazhdimësi, rivitalizimin e Termocentralit "Kosova A", rishikimin e Ligjit për paga dhe rritjen e shujtës së ushqimit.

Kryetari i Sindikatës, Nexhat Llumnica, u ka bërë thirrje të gjitha institucioneve që t'i kenë parasysh kërkesat e tyre dhe mos t'i shtyjnë punëtorët që të dalin në protesta. "Ne u bëjmë thirrje institucioneve mos të na nxisin të dalim në protesta, por që kërkesat tona të zbatohen", ka thënë Llumnica.

Ndërkaq përfaqësuesi tjetër Selatin Sadiku ka thënë se me vendimet e fundit të institucioneve po tentohet të minimizohet roli i punëtorëve të KEK-ut duke i barazuar ata me shërbyesit civilë. "Me vendimet e fundit po tentojnë të na barazojnë me administratën dhe shërbyesit civilë. Menaxhmenti i KEK-ut duhet të angazhohet për realizmin e kushteve të punëtorëve", u shpreh ai.

Realizimin e kërkesave të punëtorëve e ka kërkuar edhe kryetar i sindikatës "Kosova B", Muharrem Gashi, i cili ka theksuar se këto kërkesa duhet të realizohen, përndryshe nuk do t'i ndalin protestat.

Mbështetje protestuesve u ka dhënë edhe kryetari i Sindikatës së Telekomit, Lamih Balaj dhe ai i KOST-it, Adem Gashi.

# Klubi i Prodhuesve reagon ndaj vendimit të Maqedonisë për ndalimin e importit të peshkut nga Kosova

**Prishtinë, 25 qershor (ER)** - Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka reaguar ndaj vendimit që ka marrë Maqedonia Veriore për ndalimin e importit të peshkut nga Kosova, ndalesë kjo e cila vjen nga rregullorja për import dhe transit, ku listës së vendeve të treta u ndalohet importi i peshkut të gjallë i cili është për rritje apo shitje e që është me prejardhje nga Kosova. "Ky vendim i autoriteteve të shtetit të Maqedonisë Veriore vetëm sa e pengon edhe më shumë tregtinë mes të dy vendeve, por për Kosovën është edhe një anëtare



e CEFTA-s e cila nuk respekton marrëveshjet e përbashkëta për tregti të lirë, pas Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Shqipërisë", thuhet në reagimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Sipas tyre, ky vendim i dëmton drejtpërsëdrejti bizneset vendore të cilat merren me kultivimin e peshkut, pasi që Maqedonia Veriore ka qenë një ndër tregjet më të rëndësishme për shitjen e peshkut të gjallë nga prodhuesit e Kosovës. "Gjatë vitit 2018 Kosova ka eksportuar peshk të gjallë në Maqedoninë Veriore në sasi të 26 tonelatave dhe vlerë të 95 mijë eurove. Në vitin 2019, vetëm në muajin maj, vlera e eksportit ka qenë 23 mijë euro, e që është disa herë më e lartë se në muajt paraprakë", është theksuar në reagimin për media. Sipas këtij reagimi, Klubi i Prodhuesve shpreh shqetësimin dhe kërkon nga autoritetet e vendit tonë që të reagojnë dhe të kërkojnë nga autoritetet maqedonase ta rishikojnë edhe një herë vendimin dhe të tregohen arsyet e vërteta të këtij ndalimi.

Njëkohësisht, Klubi i Prodhuesve ka kërkuar që marrëveshjet për tregti të lirë të zbatohen dhe bllokada të tilla, të cilat dëmtojnë prodhuesit kosovarë, të mos ndodhin në të ardhmen.

## Monopoli në homologim, përplas Lekajn me deputetët

**Prishtinë, 25 qershor**- Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka raportuar të martën në Komisionin për Zhvillim Ekonomik e Infrastrukturë lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave.

Gjatë këtij raportimi u zhvillua një debat i ashpër mes deputetëve edhe ministrit Lekaj, i cili këmbëngulte se është duke e zbatuar ligjin dhe se përgjegjës për çështjen e monopolit të homologimit është ministri i kaluar, Lutfi Zharku. "Unë si ministër jam i obliguar që më përpikëri ta përpiloj ligjin e aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ministria ka nxjerr ligjin për homologimin e automjeteve i cili është i sponsorizuar nga ministri Zharku, në asnjë formë nuk kemi luajtur por ligji e ka mundësuar. Ne jemi munduar që mos të kemi monopol. Me vjen keq që unë s'kam qenë në Kuvend kur është miratuar ky ligj. Pagesa është 84 euro plus TVSH", u shpreh Lekaj.

Ai ka thënë se zbatojnë të gjitha standardet e BE-së për kushtet e automjeteve të cilat prodhohen në BE.

Deputetja Hykmete Bajrami ka thënë se ligji nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe se përgjegjës për këtë gjendje e bëri ministrin aktual, Pal Lekaj.

Ndërkaq deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka pyetur nëse kompania që bën homologimin ka kontratë dhjetëvjeçare dhe se nga kush është nënshkruar.

Ndërsa ministri Pal Lekaj, ka thënë se kjo kontratë është nënshkruar në vitin 2008 nga Fatmir Limaj.

Deputeti Glauk Konjufca ka thënë se gabimi i madh u bë në vitin 2008 kur iu mundësua një kompanie monopoli.



# Komuna e Mitrovicës vazhdon mbështetjen për fermerët

MITROVICË, 25 QERSHOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve dhe planeve zhvillimore në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Komuna e Mitrovicës ka realizuar projektin "Subvencionimi i fermerëve me koshere bletësh dhe pajisje, bimë mjekësore aromatike dhe dredhëz" në bashkëpunim me Organizatën Caritas-i Zviceran. Në kuadër të këtij projekti kanë përfituar gjithsej 19 fermerë dhe të cilëve u janë dhuruar paketa me pajisje për bletë dhe dy fermerëve të tjerë pajisje për bimë mjekësore aromatike dhe dredhëz.

Vera e përgjithshme e këtij projekti është 44 000 euro, me ç'rast Komuna e Mitrovicës ka participuar 35 për qind, fermeri 15 për qind dhe Caritasi Zviceran 50 për qind. Me këtë rast nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, ka uruar fermerët përfitues të këtij projekti, duke thënë se kjo ndihmesë është një shtysë për ta që të vazhdojnë të merren me prodhimin e mjaltës.

Po ashtu, nënkryetari Mujka ka theksuar se investimet në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë një ndër prioritetet e zhvillimit ekonomik të Komunës së Mitrovicës. "Komuna vazhdimisht do të mbështesë dhe do t'i rrisë investimet në sektorin e bujqësisë, duke i mbështetur fermerët përmes subvencioneve dhe grandeve", ka thënë Mujka.



# Fushë-Kosova bëhet me sistem të ujit të pijshëm




FUSHË KOSOVË, 25 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Fushë-Kosovës të martën është inauguruar sistemi i ujit të pijshëm në të cilin janë investuar rreth gjysmë milioni euro. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka thënë se ky është investimi më i madh që nga pas lufta. Ai ka shprehur optimizëm se tash e tutje do të ketë ujë të pijshëm 24 orë. "Shpresojmë që Fushë-Kosova do të ketë 24 orë ujë nga kompania. Ky është një nga sukseset më të mëdha që nga paslufta", ka deklaruar Berisha.

Kurse kryeshefi i Ujësjellësit, Ilir Abdullahu, u ka bërë thirrje qytetarëve të mos e keqpërdorin ujin. "Qytetarët e Fushë-Kosovës e kanë kërkuar këtë dhe po bëhet punë e mirë. Kemi nevojë nga qytetarët që të mos e keqpërdorin ujin", është shprehur ai.

Ndërsa ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka theksuar se shumica e keqpërdorimi të ujit bëhet nga kyçjet ilegale. "Është investim jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendin, investim rreth gjysmë milioni euro që përfshinë rreth 50 mijë banorë, me të vërtetë investim i qëlluar sepse investimi nuk është aq i madh sa është puna e mirë për vendin dhe qytetarët", ka deklaruar Lluka.

# Vazhdon zgjedhja e kryesive dhe kryetarëve në fshatrat e Malishevës

MALISHEVË, 25 QERSHOR (ER) - Ka vazhduar mbajtja e zgjedhjeve në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës, ku janë duke u zgjedhur kryesitë dhe kryetarët e tyre. Zgjedhjet janë mbajtur në fshatin Berishë, Fshat i Ri, Shkarashnik, Gollubovc dhe Plloqicë, ndërsa procesi i zgjedhjeve është monitoruar nga komisioni komunal për organizmin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në fshatra dhe vendbanime.

Në Berishë kryetar i fshatit është zgjedhur Eshref Berisha, në Fshat të Ri Arton Zogaj, në Shkarashnik Milaim Thaçi, në Gollubovc Hasan Morina dhe në Plloqicë Gani Thaçi.

Pjesa dërrmuese e fshatrave të Komunës së Malishevës tashmë i kanë zgjedhur kryesitë e reja dhe kryetarët të cilët do t'i përfaqësojnë ata në katër vjetët e ardhshëm.



# Qeveria premton zgjidhje të qëndrueshme për ujë të pijshëm për Gjilanin

Prishtinë, 25 qershor (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të martën në takim zëvendësministrin e Ministrisë së Infrastrukturës, Rexhep Kadriun, me të cilin kanë diskutuar për modalitetet e tejkalimit të situatës emergjente me ujin e pijshëm për qytetin e Gjilanit. "Për furnizimin e rregullt të qytetarëve me ujë të pijshëm ekzistojnë dy alternativa, investimi në mbushjen e ujëmbledhësit të Përlepnicës nga lumi Krivareka ose nga lumi Llapushnik", ka thënë Haradinaj pas takimit. Ai ka shtuar se qeveria e vendit me marrjen e mandatit ka investuar në rindërtimin e pendës së Përlepnicës, rrjetin shpërndarës si dhe impiantin e ujërave të zeza dhe do të vazhdojë të jetë e fokusuar për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme sa i përket ujit të pijshëm për Komunën e Gjilanit.



# ELITAT SHQIPTARE GJITHNJË NË SHËNJESTËR



Nga Jakup KRASNIQI

Që në fillim të këtij shkrimi dua ta risjell në kujtesë, (koincidencë rastësore apo jo, mbase edhe jo pa rëndësi, le ta vlerësojmë së bashku), se elitat shqiptare gjithnjë kanë qenë në shënjestër të eliminimit, përkatësisht dobësimit deri në shkatërrim të plotë. Kjo ndodhi sidomos gjatë dy shekujve të fundit, duke e lënë popullin shqiptar si peshkun në rërë.

Eliminimin e elitave shqiptare e pati filluar Perandoria Osmane që para Masakrës së Manastirit, në vitin 1830, një ekuivalencë kjo e pogromit ndaj hebrenjve në Rusi, i njohur botërisht, dhe që ka vazhduar deri në nëntorin e vitit 1912, kur Shqipëria u pavarësua pas shekujve robërie.

Eliminimi i elitës, respektivisht elitave shqiptare, nisi edhe pas pavarësisë, sidomos atëherë kur Qeveria e Ismail Qemalit u detyrua të dorëhiqej. Me atë dorëheqje u eliminua klasa e pavarësistëve, e luftëtarëve të dalluar për kombin e shtetin shqiptar. Shumë prej tyre kishin shkrirë pasuri e katandi për liri e pavarësi, për shqiptari e Shqipëri të të gjithë shqiptarëve.

Historia na tregon se, për fat të keq, eliminimi i elitave atdhetare shqiptare vazhdoi edhe gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XX. Ky eliminim i elitave vazhdoi dhe u thellua pas vitit 1925, kur në pushtet, me ndihmën e qeveritarëve serbë e grekë u kthye Ahmet Zogolli. Ai eliminoi sidomos dy kategoritë më të nevojshme për kombin: luftëtarët më të dëshmuar për komb e atdhe dhe intelektualët më të mëdhenj të kohës. Shumë prej tyre u vranë brenda e jashtë atdheut, si Luigj Gurakuqi e Hasan Prishtina, si dhe shumë të tjerë, si Fan. S. Noli, morën rrugën e ikjes nga atdheu, për të cilin kishin sakrifikuar shumë. Kjo ishte ikje për t'i shpëtuar vdekjes e dikush mund ta quante "ikje nga liria"! Ata që i shpëtuan eliminimit a ikjes u harruan ose u dhanë pas gotave të rakisë. Rasti më eklatant i kësaj forme eliminatore ishte poeti e luftëtari Mihal Grameno.

Ndërsa në hapësirat shqiptare të mbetura jashtë Shqipërisë, në Jugosllavi, Serbi e Greqi, eliminimi i elitës shqiptare nuk është ndërprerë asnjëherë pas vitit 1913. Në fakt, politikat e këtyre të fundit ishin politika gjenocidi, pasi kishin për qëllim shuarjen e tërësishme ose të pjesshme të shqiptarëve si komb.

E keqja vazhdoi në këto përmasa edhe pas Luftës së Dytë Botërore; madje deri në ditët tona eliminimi i elitave intelektuale të krijuara me shumë mund, vështirësi e investime, çuditërisht si një mallkim "biblik", nuk pushoi asnjëherë!

Periudha e komunizmit edhe pse krijoi elita të shumta në shumë fusha të jetës intelektuale, profesionale, kulturore, shkencore e artistike, u tregua shumë e dhunshme dhe eliminatore ndaj shumë elitave kombëtare të krijuara para Luftës së Dytë Botërore. Vetëm dekada e fundit e shekullit XX do të sillte një frymë të re politike e demokratike, edukative, kulturore e humanitare nga politika e re shtetërore. Në këtë politikë të quajtur demokratike, elitat intelektuale, shkencore e artistike të kombit do të kishin një rol më me ndikim. Por kjo nuk ndodhi dhe ato u lanë në harresë nga politikanët e zhdërvjellët (të majtë e të djathtë), të rrethuar nga puthadorët e tyre. Këta të fundit, bashkë me shefat e tyre janë zhurmuesit dhe shurdhuesit e çdo mendimi apo ideje të kundërt, sidomos brenda përbrenda "partive" të tyre.

Kjo që u tha jo vetëm që nuk ndodhi në dekadën e fundit të shekullit XX, por nuk është duke ndodhur as në fund të dekadës së dytë të shekullit XXI. Dhe kjo shëmti nuk është duke ndodhur vetëm në një hapësirë të kufizuar të kombit tonë, por në të gjithë hapësirën tonë kombëtare, ku ka organizim politik e shtetëror dhe ky fakt dhemb shumë. Intelektualë të ndryshëm, shkencëtarë, shkrimtarë, artistë, mjekë, gjyqtarë dhe ekspertë të shumtë, sidomos ata që kanë kredo intelektuale e profesionale, kanë mbetur vrima e fundit e kavallit, siç thotë një fjalë nga urtia e pasur e popullit.

Kaosi i përgjithshëm ka mbuluar hapësirën tonë kombëtare, kaos që po bren dhe po rrezikon shumë të ardhmen e kombit.

Kjo si pasojë, sepse hapësira shqiptare po qeveriset nga fuqia e muskujve dhe jo nga mendja e dijes dhe e përgjegjësisë drejtuese. Mbase kjo është pasojë, se zgjedhjet në hapësirat tona kombëtare në këto njëzet-tridhjetë vitet e fundit nuk kanë qenë zgjedhje të lira, të drejta e demokratike, prandaj jemi në një udhëkryq të madh. Nuk mund të ketë zgjedhje të lira e demokratike, aty ku "zgjedhjet" partiake janë autoritare apo "zgjedhje" me grushte e karrige.

Në të dyja rastet shurdhohet debati dhe mendimi intelektual. Për çudi këto veprime aspak demokratike, intelektuale e njerëzore merren si shembuj pozitivë, sidomos autoritarizmi i individit. Kjo qasje tregon shkallën e lartë të mjerimit tonë intelektual; tregon mungesën e integritetit e të dinjitetit të njeriut tonë e sidomos të atyre që shiten si mbrojtësit e demokracisë!

Gjatë gjithë këtyre viteve ne nuk kemi parë drejtues politikë, kryetarë shteti a kryeqeveritarë, që ofrojnë në trupat këshilluese njerëz me integritet politik, intelektualë apo ekspertë të ndryshëm, që dinë e duan të këshillojnë si të merren vendimet e si të qeveriset vendi.

Por të gjithë kemi parë se si i afrojnë njerëzit pa asnjë përvojë qeverisëse, madje në ndonjë rast, dhe jo rrallë, në kabinete të ndryshme të qeveritarëve sjellin individë sa për t'u dhënë një pagë mujore apo për t'u bërë një zgjidhje sociale. E këta njerëz jo pak herë bëhen deputetë, ministra e zëvendësministra.

Kështu vendi nuk qeveriset, madje kështu as nuk administrohet! Ndoshta qeveritarët tanë janë të gjithëdijshëm, magjistarë sui generis!

Historia e qeverisjeve të suksesshme ka treguar se drejtues apo qeveritar i suksesshëm është ai, që nuk është i gjithëdijshëm, por që di të afrojë rreth vetes njerëz profesionistë e me integritet. Ndërsa te ne, të "gjithëdijshmit" që merren me çdo gjë, në fakt nuk merren me asgjë!

Kjo po ndodh edhe te drejtuesit e shteteve tona, të cilët merren me gjithçka, por jo me atë për të cilën janë caktuar të bëjnë: ta qeverisin vendin për mirëqenien e kombit. Edhe këtë nuk janë duke e bërë.

E gjithë kjo është pasojë, se në shoqërinë shqiptare mungon debati elitar, ku secili është "mbret më vete apo shah në veti", siç thotë populli ynë i urtë! Këtu secili mund të bëhet kryetar shteti, kryeministër apo, e pakta, deputet a ministër! Ndoshta "shkopi është vendosur ulët" dhe secili mund ta kapërcejë atë!

Një qeverisje që nuk respekton elitat e veta, duke i goditur, dobësuar apo shkatërruar ato, në fakt do t'i kthehet si bumerang fatit të tyre. Viteve të fundit këtij fenomeni i është kontribuar edhe me injorimin nga më të fortët, por edhe me vetënënshtrimin e qyqarëve.

Kujdes! Kujdes! Kujdes duhet të keni të gjithë ju, kushdo që jeni e ngado që jeni, që po mbështesni autoritarizmin e individit, "njëshit", e jo vendimin e organeve të zgjedhura, qofshin ato partiake apo shtetërore (Qeveri, Kuvend e Drejtësi), duhet ta dini se nuk po mbështesni forcimin e shtetit të së drejtës, por vazhdimin e agonisë e të mjerimit intelektual dhe ekonomik në shoqërinë tonë! Peshqit rendin pas karremit, por përfundojnë në grep.

Me këtë formë e nivel të mjerimit të shpërfaqur në debatin e këtyre ditëve, zhvillimi i demokracisë dhe ndërtimi i shtetit të së drejtës në Kosovë janë tepër larg!

Përpiqem ta kuptoj zhurmimin e shurdhimin e mendimit elitar në rrjete sociale, portale e medie të tjera private a qeveritare, në parti a partiçka politike, por është vështirë të kuptohet heshtja aty ku duhet të ketë elitë intelektuale apo akademike!

Ose, mbase, shqiptarëve as në këtë shekull nuk u duhet mendimi elitar!

# UPZ-ja arrin marrëveshje me OJQ FINQ-i për krijimin e kopshtit botanik për nevoja të FShJM-së

**Prizren, 25 qershor (ER)** - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren të martën ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me OJQ FINQ. Marrëveshjen përkatëse e kanë nënshkruar rektori i UPZ-së, prof. asoc. dr. Ismet Temaj dhe Nexhmendin Ramadani, drejtor i OJQ FINQ. Në bazë të kësaj marrëveshje UPZ-ja do të shfrytëzojë një sipërfaqe prej dy hektarësh të kësaj organizate për Kopshtin Botanik për nevoja të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit deri në krijimin e kopshtit botanik në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, ndërsa UPZ do t'i ofrojë mbështetje kësaj organizate me ekspertiza të ndryshme dhe shfrytëzimin e laboratorëve dhe hapësirave të FShJM-së. Në takim ishin edhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, prof. asoc. dr. Isuf Lushi dhe shefi i Programit i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit, prof. ass. dr. Faruk Bojagji.



## Palestinezët bojkotojnë konferencën e ShBA-së për Lindjen e Mesme

MANAMA, 25 QERSHOR - Palestinezët dhe mbështetësit e tyre kanë protestuar kundër konferencës dyditore në Bahrejn, ku Shtetet e Bashkuara prezantuan planin e tyre për paqe në Lindje të Mesme. Presidenti amerikan Donald Trump e ka quajtur planin e krijuar nga dhëndri i tij, si marrëveshja e shekullit për palestinezët. Nuk është ende e qartë nëse plani ekonomik ka mundësi që të zbatohet pa një zgjidhje politike më parë. Palestinezët e kanë bojkotuar Uashingtonin qëkur presidenti Trump njohu Jerusalemin kryeqytet të Izraelit në vitin 2017.
Protestuesit marshuan të hënën në Bregun Perëndimor, një ditë përpara konferencës së organizuar nga ShBA-ja për Lindjen e Mesme, në kryeqytetin e Bahrejnit, Manama.
Mijëra përkrahës ishin edhe në rrugët e kryeqytetit të Marokut, Rabat. "Shtetet, individët, qeveritë dhe institucionet që marrin pjesë në konferencë kanë zgjedhur kampin e tradhtarëve", thotë një protestues.
Edhe midis vetë vendeve pjesëmarrëse ka opinione të ndryshme për takimin, që njihet edhe si "Paqe drejt begatisë".
Arabia Saudite, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe, Egjipti, Jordania dhe Izraeli kanë konfirmuar pjesëmarrjen, por nuk kanë dërguar zyrtarët e tyre më të lartë.
ShBA-ja përfaqësohet nga sekretari i Thesarit, Steven Mnuchin dhe dhëndri i presidentit Trump, Jared Kushner, që është edhe hartues i planit.



# Kampi demokrat, gati për garën presidenciale brenda partisë

**Debatet e para do të mbahen të mërkurën dhe të enjten, në të cilët do të paraqiten dhjetë konkurrentë të ndryshëm çdo natë që konkurrojnë për të fituar të drejtën për t'u përballur me presidentin Donald Trump në nëntor të vitit 2020**



UASHINGTON, 25 QERSHOR - Beteja për zgjedhjen e kandidatit presidencial të Partisë Demokrate fillon këtë javë, me debatin e parë të atyre që do të jenë debate mujore mes kandidatëve përpara zgjedhjeve paraprake në fillim të vitit të ardhshëm. Debatet e para do të mbahen të mërkurën dhe të enjten, në të cilët do të paraqiten dhjetë konkurrentë të ndryshëm çdo natë që konkurrojnë për të fituar të drejtën për t'u përballur me presidentin Donald Trump në nëntor të vitit 2020.
Mund të jetë kampi më i ngarkuar demokrat i të gjitha kohëve, i udhëhequr tani nga ish-nënpresidenti Joe Biden. Argumenti i Bidenit është se ai është kandidati më i fortë për t'u ndeshur me presidentin Donald Trump vitin e ardhshëm, ka njoftuar voa. "Shpresoj të jem i emëruari juaj dhe do të punoj sa të mundem për ta marrë mbështetjen tuaj. Por, ju them se cilido që të jetë kandidati demokrat, ne duhet të qëndrojmë së bashku dhe të zgjedhim një president demokrat të Shteteve të Bashkuara të Amerikës!", tha ai.
Ditët e fundit Bideni është sulmuar se ka mbrojtur punën e tij të gjatë kohë më parë me dy senatorë që mbështesnin ndarjen raciale, potencialisht duke hapur një betejë të re për të.
Pas Bidenit në anketa është senatori i Vermontit, Bernie Sanders dhe senatorja e Massachusetts, Elizabeth Warren, e cila është ngritur me shpejtësi. "Kjo është demokracia. Të kesh mundësi të dalësh të takohesh me njerëzit dhe të kesh shansin të flasësh për vizionin që ke për Amerikën. E dini se nuk mjafton vetëm t'i thuash 'jo' Donald Trumpit", tha ajo.
Pete Buttigieg, dikur kryetar pak i njohur i bashkisë së South Bendit, në Indiana dhe senatorja e Kalifornisë, Kamala Harris, janë në nivelin e kandidatëve që gëzojnë mbështetje të lartë.
Një grup i madh i pretendentëve të tjerë demokratë vazhdon të mbetet prapa, duke shpresuar ta marrë vëmendjen e duhur përmes një performance të mirë në debat.
Debatet shënojnë një kthesë në fushatë, thotë analisti Kyle Kondik. "Mendoj se debatet janë bërë ngjarjet kryesore të sezonit të zgjedhjeve paraprake, veçanërisht pasi janë të gjithë këta kandidatë nga i gjithë vendi që shkojnë në disa nga shtetet kryesore të zgjedhjeve paraprake dhe pothuajse në të gjithë vendin. Por, në të vërtetë, nuk kemi ndonjë votim deri në fillim të shkurtit të vitit të ardhshëm", tha ai.
Kandidatët do të jenë nën presion për të bërë përshtypje sa më shpejt, thotë eksperti Larry Sabato. "Do të ketë katër, pesë apo gjashtë kandidatë që do t'i gjejnë fjalët e duhura, sulmet e duhura ndaj njëri-tjetrit apo ndaj presidentit Trump për ta tërhequr vëmendjen. Ata do të jenë ata që do t'i fitojnë nga debatet. Të tjerët mund të humbasin mbështetje dhe donatorë", tha Sabato.
Presidenti Trump ka të ngjarë të jetë pika qendrore e sulmit në debatet e demokratëve dhe ai tashmë mezi pret të përballet me kundërshtarët demokratë.
"Kundërshtarët tanë radikalë demokratë janë të nxitur nga urrejtja, paragjykimet dhe zemërimi. Ata duan t'ju shkatërrojnë dhe ta shkatërrojnë vendin tonë siç e njohim. E papranueshme. Nuk do të ndodhë", tha Trumpi.
Elizabeth Warren është kandidatja kryesore në debatin e parë (e mërkurë), ndërsa Bideni, Sandersi, Buttigiegi dhe Harrisi do të jenë të gjithë në skenë në natën e dytë të debatit të enjten.

## Erdogani thotë se do të nxjerrë mësime nga humbja në Stamboll

ANKARA, 25 QERSHOR - Në paraqitjen e tij të parë në publik pas humbjes së partisë së tij në zgjedhjet e përsëritura për kryetarin e Bashkisë së Stambollit, presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan u zotua të martën se do të nxjerrë mësime dhe do të bëjë disa rregullime bazuar në "mesazhin e dhënë nga populli". Duke iu drejtuar ligjvënësve të partisë së tij në Parlament, Erdogan e uroi përsëri kandidatin e opozitës, Ekrem Imamoglu, i cili fitoi 54.21 % të votave në zgjedhjet e së dielës për kryetarin e Bashkisë së Stambollit.
Erdogani e pati përgëzuar më parë Ekrem Imamoglun me një postim në "Twetter".
Rezultatet e zgjedhjeve të së dielës shënuan një humbje të rrallë elektorale për Erdoganin dhe partinë me prirje islamike që udhëhiqte prej vitesh Bashkinë e Stambollit, qyteti më i rëndësishëm i Turqisë. Kjo ishte, gjithashtu, një goditje personale ndaj Erdoganit, fuqizimi i të cilit në politikën turke filloi me zgjedhjen e tij kryetar bashkie, 25 vjet më parë.
Duke folur për gazetarët, kryeministri turk tha se nuk do të përjashtonte një riorganizim të qeverisë pas disfatës të së dielës.
Zgjedhjet e përsëritura të së dielës në Stamboll u mbajtën, pasi partia në pushtet e kundërshtoi rezultatin për shkak të dyshimeve për parregullsi dhe Komisioni Zgjedhor anuloi rezultatet dhe mandatin e Imamoglu pas 18 ditësh.
Në votimet e së dielës, Ekrem Imamoglu fitoi me një dallim prej 800 mijë votash, krahasuar me një dallim prej 13 000 votash që pati në votimin e parë. Fitorja e tij elektrizoi partinë laike të opozitës, që ka kaluar pothuajse dy dekada në opozitë, qëkur Rexhep Tajip Erdogan forcoi pushtetin e tij.



# DHEMBJA INDIVIDUALE E PËRBOTSHME



RESMIJE KRYEZIU

Gjatë jetës ballafaqohemi me gëzime dhe hidhërime. Nëse gëzimet na përsëriten mësohemi me to dhe nuk dimë ta çmojmë vlerën që ka një buzëqeshje, një fjalë e mirë, një përkëdheli. Dhembja e përsëritur na topitë dhe nga tretja e ngopur nuk mund ta përballojmë atë dhe e bindim veten ta harrojmë, ta fshijmë nga kujtesa atë që na ka lënduar dhe, atëherë, fatkeqësisht, dhembjet na ripërsëriten.

Me romanin "Lodrimi i madh i vdekjes" Kristaq F. Shabani arrin që, duke e personalizuar dhembjen me personazhe reale, këtë dhembje ta bëjë të përbotshme.

Këta njerëz që janë bartës të dhembjes së tyre reale, kështu si janë paraqitur në këtë vepër, ata nuk janë më personazhe, por duke qenë pjesë e dhembjes, dhembje që nuk është më vetëm e tyre, shndërrohen në bartës të dhembjes, ndër njerëzit, kohët dhe meridianët duke e shndërruar dhembjen e tyre në dhembje të të gjithëve.

Kjo formë e të shkruarit sado që i zgjeron horizontet e përjetimit letrar, duke ua veshur petkat e bashkëkohësisë dhe të kohëve që do të vijnë, faktin jetësor e shndërron në artefakt letrar dhe për ne që e njohim këtë realitet, i besojmë asaj që lexojmë, ndërsa ata që janë jashtë këtij qarku të cilit ne i takojmë, këto fakte, edhe pa ditur që janë realitet, si realitet do t'i pranojmë. Dokumentet historike që janë dëshmi e ravijëzimit të shtigjeve të krijimit neve na përkujtojnë se ajo çka ka ndodhur me shqiptarët e Kosovës në fundshekullin e njëzet s'është rastësi, apo çmenduri e një individi, por platformë vrastare e politikave sa antishqiptare aq edhe antinjerëzore. Se kush tha se Hegeli kishte thënë: "Nëse nuk pajtohemi me fakte - vaj halli për faktet". Autori Kristaq F. Shabani na përkujton me një ftohtësi se vetëm duke i vlerësuar faktet nga e kaluara duhet të nxjerrim mësime për të sotmen dhe për të ardhmen. "Lodrimi i madh i vdekjes" është roman që është realizuar mbi përvojën e romanit modern dhe postmodern, që është menduar, para së gjithash, si mjeshtri e kombinuar, si një lloj i veçantë që bashkon strukturat letrare dhe joletrare në një shprehje artistike gjuhësore, të bazuar në mundësitë e pakufishme të kombinimeve të elementeve të ndryshme, reales dhe joreales, faktit dhe materialit të stisur.

Stili i tij letrar nuk është një gjerdan i zbukuruar, por gjuhë që, në vend se të na kënaqë, na detyron të mendojmë. Kjo vepër mund të cilësohet si vepër postmoderne, në shtratin e së cilës rrjedhin në mënyrë të barabartë format e ekstremit stilistik pluralist, ku pa ngurrim luhet me zhanre, duke i ndërlidhur shenjat e ndryshme semiotike në tërësinë letrare. Ky përkufizim stilistik nuk e pengon lexuesin dhe nuk kërkon nga ai që për ta lexuar dhe kuptuar këtë vepër që të jetë njohës i shtigjeve bashkëkohore të letërsisë - përkundrazi, pikërisht kjo formë e të shkruarit atë e bën bashkëpjesëtar, dëshmitar të fakteve të pakontestueshme që u kanë ndodhur të tjerëve, pavarësisht a janë ata bashkëkohës të personazheve që janë subjekte të vërtetë të atyre fakteve apo lexues të panjohur dhe të painformuar për ato fakte që janë objekt i kësaj vepre. Kjo mënyrë e të shkruarit i fshin kufijtë e kohës dhe hapësirës duke u bërë pjesë e gjithë njerëzimit dhe përmbajtje e ndërgjegjes njerëzore, pavarësisht ku gjenden ata.

Në fillimet e këtij romani që s'është roman, tregimi që s'është tregim, vepër shkencore që nuk është vepër shkencore, e që prapë ngjason të jetë me karakteristika të të gjitha atyre që u thanë se nuk u takon, çuditërisht në vete ka shumëçka që i përkufizon kufijtë dhe logjikën apo jologjiken e ekzistencës njerëzore; ballafaqohemi me reflektime që secili veç e veç dhe të gjithë bashkërisht na ndërgjegjësojnë për huqet dhe sukseset e shtegtimit të njeriut nga stadet më të ulëta të civilizimit deri te paroksizmi i politikës, nebulozat e filozofisë. Në të gjithë këtë tentativë të zbërthimit të kuptimeve të dritëhijeve të ekzistencës njerëzore qëndron etaloni themeltar i gjakimit për harmoni. Kjo harmoni që niset nga shtatërrokëshi muzikor që nis e përfundon me bazën e pentagramit, sikur lypset që në këtë thjeshtësi përmbajtjesore, e në të njëjtën kohë qetësi universi, të kërkohet vendi për rriten dhe ruajtjen e gjenit tonë kombëtar që u bëri ballë vorbullave historike gjithmonë duke e pasur parasysh pyetjen, ku ishim, a ishim vërtet pjesë e këtij amalgame njerëzore që ndër shekuj ndërroi ngjyrë duke u përzierë me kultura që si lumenj na vërshuan. Ku nisi dhe ku u tret dhe prapë u ngjall ai fill i humbur në mugëtira të kohëve në kërkim të vendit të merituar në agimet e civilizimeve. Sa plagoma apo shekuj drite u larguam nga shtegu fillestar - janë dilema që dridhërojnë në faqet e këtij libri të çuditshëm të autorit Kristaq F. Shabani.

Të gjitha këto pyetje së bashku nuk japin shpjegime, por na qëllojnë si flakë rrufesh duke na detyruar të mendojmë se: kush ishim, ku ishim, kush jemi dhe kah po shkojmë. A mos kemi humbur? A mos e kemi gjetur vetveten në një vend të njëjtë e prapë ndryshe? Të gjitha këto janë pyetje që nuk ofrojnë përgjigje, tundime që na detyrojnë të reflektojmë për veten tonë nëse nuk dëshirojmë të humbim ndër rrudha, hone të harresës së historisë. Këto valë shqetësimi, që si oqean i tërbuar i mbamendjes njerëzore e rrahin autorin, duke e përplasur, por duke mos e vrarë, sikur kanë qëllim që ai shqetësim të bartet te lexuesi dhe, siç thotë filozofi spanjoll Miguel de Unamuno: "Populli im, të dua aq shumë sa, me kënaqësinë më të madhe, do të ta hapja zemrën dhe në të do të të fusja kripë që kurrë të mos jesh i qetë". Kripa e veprës së Kristaq F. Shabanit faqe pas faqe na i përplas para syve të vërtetat që sa të lëndojnë aq të detyrojnë t'i hapësh sytë në kërkim të së vërtetës. Krijuesi nuk jep përgjigje, ai shpalos tema të cilat ngrehin pyetje që secili nga ne duhet ta gjejë përgjigjen e vet.

Kjo materie edhe emërtimin e ka të çuditshëm, "Lodrimi i madh i vdekjes", neoroman dramë. Pikërisht ky emërtim është udhërrëfyes drejt shpalosjes së mistereve të ekzistencës njerëzore në përgjithësi dhe kombëtares në veçanti. Kjo formë e shprehjes sikur lë mundësi që pa humbur nga kuptimi, romani të lexohet qoftë nga gjysma, qoftë nga fillimi, për arsye se ashtu si përsëritet shtatë notesi muzikor, përsëritet edhe jeta e njeriut që modifikohet me pak, e ajo "pakës" në jetën e njeriut mund të prodhojë sa shumësi qoftë të mira qoftë të këqija. Kjo formë e të shkruarit nuk kërkon pëlqim apo nuk ka synim pëlqimin. Kjo vepër synon të na shqetësojë dhe nga ky shqetësim intelektual, të na shtyjë në aventurën e zbulimit të së vërtetës, sa për qenien njerëzore aq edhe për vetën tonë.

Emrat që përdoren në këtë vepër kanë rastisur të jenë të vërtetë. Emrat e atyre që kanë pësuar në këtë rrugëtim të golgotës shqiptare, i dinë familjarët e njerëzve të përmendur, qofshin ata të gjallë apo që kanë pësuar. Për lexuesit që nuk i njohin këta emra nuk kanë ndonjë kuptim të madh, por përjetimet e tyre e bartin emrin ee tyre. Dhe, siç thotë Zhak Derrida në studimin e vet, nga "Levi Strosi deri te Rusoi": "Emri shëmbëllen shenjën për njohje. Gjatë identifikimit të të tjerëve, gjegjësisht duke i klasifikuar ata, ne e bëjmë edhe klasifikimin dhe identifikimin e vetes sonë". Në këtë vepër, emrat e përveçëm, qofshin ata burra apo gra, dallojnë; e përbashkëta e të gjithë atyre është dhembja, flijimi apo qëndresa. Pse autori i përmend emrat? Sado që këta emra janë të vërtetë për ata që e njohin ngjarjen dhe mjedisin ku ajo ngjarje ka ndodhur, për lexuesit që njihen për herë të parë me këtë ngjarje, emri është edhe një vulë në përforcimin e faktit për të cilin bën fjalë ngjarja. Edhe kjo mënyrë e shprehjes të së vërtetës është e mirëqenë në kuadër të formës së përzgjedhur të trajtimit të kësaj materie letrare. Përdorimi i emrave të vërtetë të njerëzve përputhet me metodën e postmodernizmit, ku pjesë dhe ngjarje nga historia trupëzohen në vepër si pjesë të romanit.

Gjatë leximit të veprës "Lodrimi i madh i vdekjes" na përkujtohet ndjeshmëria që lindet nga leximi i veprave të antikes greko-romake. Ngjarjet që në të kaluarën e historisë së njerëzimit kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në histori dhe kujtesën e njerëzimit ngjasojnë me ngjarjet që janë subjekt i kësaj vepre. Luljeta Sharani është një Hekubë e kohës sonë dhe jo vetëm aq, por shumë më e fuqishme se Hekuba e Trojës, gruaja e Prijamit, nëna e Hektorit të vrarë. Vaji i saj që në letërsinë botërore çmohet si një artikulim sublim i dhembjes së nënës për të birin e vrarë në luftë është më pak i fuqishëm se dhembja e Luljeta Sharanit. Hektori kishte mundësi të luftojë për jetën e tij. Të bijtë dhe bashkëshorti i Luljeta Sharanit nuk e patën atë mundësi dhe pikërisht ekzekutimi i tyre rëndon shumë më tepër se vdekja e një luftëtari në fushëbetejë. Ne nuk i kemi njohur këta personazhe pikërisht pse ishin njerëz të rëndomtë që e kishin vetëm një faj - fajin se janë shqiptarë dhe se janë të gjallë. Ballafaqimi me një faj të këtillë, për sa mund të jetë faj të jetosh dhe të jesh ai që je, e spikatë egërsinë e vrasësve që e kishin humbur njerëzoren. Për ata, që nuk i kanë njohur këta njerëz, viktima të pafajshme, tmerri se pafajësia e tyre u ka sjellë vdekjen, është tmerr i pafund. Pikërisht kjo ngjarje e përkufizuar në këtë mënyrë dhe këtë formë, synon dhe ia arrin që t'i tejkalojë caqet e hapësirës fizike ku ka ndodhur kjo, duke u bërë lament për viktimat e pafajshme dhe klithmë e fuqishme në mbrojtje të njerëzores dhe akuzë e pashlyeshme për të gjithë ata që, ndonëse e kanë humbur njerëzoren, pretendojnë të qeverisin me të tjerët, pavarësisht se në ç'vend, pavarësisht se në ç'kohë. Duke i stigmatizuar vrasësit autori nuk e mbron vetëm familjen Sharani, po të gjithë ata që kanë qenë viktima vetëm e vetëm se kanë qenë gjallë dhe shqiptarë, i mbron edhe të gjitha viktimat që janë apo mund të jenë në botë ku mizoria e jonjerëzores e lufton njerëzoren.

Në këtë vepër, që është një vepër që i shqyen kufijtë e romanit tradicional, idenë e tij, përkushtimin për mbrojtje të njerëzores e mbështesin qoftë fjalimet e Klintonit dhe të Blerit, që u paraprijnë shpëtimtarëve lidhur me luftën e Kosovës, qoftë shkrimet e Naxhije Doçit, Aristidh P. Kolja të gazetarit Kristos Telidhis, apo kolonelit Hajro Limaj e shumë dokumente të tjera që janë pjesë përbërëse e këtij libri ngaqë, në këtë luftë për mbrojtje të njerëzores, nuk është vetëm autori i këtij libri, por janë të gjithë ata që në veprat e tyre, qofshin ato të vogla apo të mëdha, pulson ideja e mbrojtjes së njerëzores. Nëna Terezë thotë: "Për ta mbrojtur oqeanin duhet ta shpëtojmë pikën e ujit", apo si e nis Hemingueji romanin e vet Për kë bien kambanat: "Nëse një njeri vdes, njerëzimi është më pak për një njeri e, duke qenë ti pjesë e njerëzimit, me atë njeri vdes një pjesë jotja, prandaj mos pyet për kë bien kambanat", mos pyet për kë këndohen sallat nga minaret e xhamive. Ato kambana dhe ato salla bien për ty dhe këndohen për ty njeri.

Nëse duam të jemi njeri, nëse duam jetën ta bëjmë më njerëzore, të mundohemi që të ketë sa më pak kambana të vdekjes.

E rrallë

## Sorra që ngjan me gorilla po çmend internetin



Një video është shpërndarë në rrjetet sociale ku shihet një sorrë e cila ngjan si gorillë. Kjo sorrë ka shkaktuar shumë debat dhe bujë në rrjetet sociale. Pamjet u filmuan në Nagoya, Japoni dhe duket sikur sorra mbahet nga krahë të fuqishëm. Një kërkues i Universitetit të Uashingtonit tregon se kemi të bëjmë me reflekset e diellit. Kur zogjtë ndalojnë, krahët i nxjerrin përpara duke fshehur këmbët. Në momentin kur është filmuar nga kamerat zogu ka qenë duke ndryshuar pozicion dhe krijon përshtypjen se nuk ka këmbë.

FOTO E DITES



Anija shqiptare "Butrinti" duke kryer manovra për furnizimin me karburant në det me fregatën gjermane "Hessen" në Detin Egje.

E jashtëzakonshme

## E harrojnë brenda në avion, gruaja zgjohet e tmerruar në mes të errësirës

Një grua është lënë brenda në avion pasi e zuri gjumi gjatë fluturimit. Kur ajo është zgjuar brenda avionit "Air Canada" ka parë vetëm errësirë. Tiffani Adams ka thënë se e kishte zënë gjumi gjatë fluturimit nga Quebec në Toronto më 9 qershor. Kur u zgjua, Adams kishte shumë ftohtë dhe ishte ende e ulur në ulësen e saj, por avioni ishte parkuar. Ajo u shpreh se përjetonte makthe gjatë natës që kur incidenti i ndodhi. "Air Canada" konfirmoi incidentin që ndodhi dhe po heton rastin.




BARSOLETA E DITËS



**Djali: Babi, cili është dallimi ndërmjet fjalëve "pa para" dhe "badihava"?**
**Babai: Është e thjeshtë. Për shembull, ti e ke kryer shkollën e mesme pa para, por ke shkuar atje badihava.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**

**"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan

**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val







**Ne ora 18:00**

**"X-Men; Dark Phoenix"**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain

**Regjia:** Simon Kinberg

**Në ora 20:00**

**"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,**

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson

**Regjia:** F. Gary Gray







**Ne ora 22:00**

**"M A"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Ndiheni skllevër të rutinës tuaj të përditshme dhe sot do të bëni të pamundurën të shpëtoni prej saj. Do ta gjeni zgjidhjen me sukses gjatë pasdites.



**DEMI**
Jeni miqësuar shumë me një person që para pak kohësh ka qenë armiku juaj i betuar falë një situate që nuk e keni parashikuar.



**BINJAKËT**
Imazhi i vetes që po shihni në pasqyrë sot është i lodhur dhe i pamotivuar. Duhet ta gjeni forcën të ngriheni dhe të reagoni.



**GAFORRJA**
Edhe pse sot do të punoni me njerëz të ndryshëm nga ju sa i përket karakterit, do të shikoni që do të gjeni të përbashkëta.



**LUANI**
Ditën e sotme mund ta kaloni duke rregulluar marrëdhëniet me personin që do të jetë në të ardhmen në krahun tuaj.



**VIRGJËRESHA**
Sot jeni mbingarkuar dhe nuk keni mundësi të krijoni hapësira për të takuar një mikun tuaj.



**PESHORJA**
Duhet t'iu përkushtoheni më shumë personave që ju duan dhe që ju doni. Krijoni hapësirat e nevojshme për ta.



**AKREPI**
Sot duhet të rregulloni punë me një pjesëtar të familjes suaj. Keni bërë një gjest që atij s'i ka pëlqyer.



**SHIGJETARI**
Sot do të ndryshojë optika juaj mbi persona të caktuar. Ngjarjet e fundit kanë treguar që ndonjëherë paragjykoni.



**BRICJAPI**
Keni lënë të kalojë shumë kohë dhe një çështje që ju shqetësonte tani është kthyer në një problem serioz.



**UJORI**
Po planifikoni të nisni një biznes me persona që nuk i njihni mirë. Të gjithë rreth jush kanë dyshime për këtë gjë.



PESHQIT
Keni një ditë të tërë në dispozicion për të reflektuar sot dhe për të menduar se çfarë do të bëni në ditët në vijim.

# Katharine McPhe përkëdhelet me të dashurin në Greqi para dasmës



Katharine McPhee dhe David Foster nuk mund t'i mbanin duart larg njëri-tjetrit derisa po e shijonin një pushim në Mykonos të Greqisë. Çifti, që është thënë se do të martohen së shpejti, janë parë më të dashuruar se kurrë më parë. 35-vjeçarja McPhee është parë duke e admiruar të dashurin e saj shumë më të vjetër në moshë derisa ka treguar format trupore për çdo lakmi në bikinet ngjyrë ari. Aktorja amerikane kishte vënë një varëse ngjyrë ari, vathë në formë rrethore dhe e kishte vënë një kapele verore kashte.

# Justin Bieberi po punon në këngë të reja



Justin Bieberi është parë duke u përshëndetur me një mik pasi u largua nga një studio muzikore të hënën në Los Angeles. Këngëtari 25-vjeçar, i cili kishte vënë një kapelë në kokë, mbante në duar edhe një tabelë, pas përfundimit të punës në studio. Justini ka ndarë edhe një fotografi me gruan e tij Hailey në "Instagram", ku shihen së bashku në studio. Në këtë fotografi Hailey shihet teksa përqafon këngëtarin.



# Irina e lumtur pas ndarjes nga Bradley

Irina Shayk është në gjendje shumë të mirë shpirtërore. Modeluesja 33-vjeçare është parë e lumtur duke kaluar kohë me nënën e vet, të hënën në Nju Jork. Nëse nuk e dini, pak kohë më parë Irina është ndarë nga i dashuri i saj Bradley Cooper. Aktori së fundmi është parë duke e vizituar modeluesen në apartamentin e saj, disa ditë pas lajmit për ndarjen e tyre. Ata kanë së bashku një vajzë.

# Fejohet Sean McVay



Sean McVay është fejuar me të dashurën Veronika Khomyn. Ai i ka propozuar asaj fejesë dhe ajo i tha "Po". Veronika është me origjinë nga Ukraina dhe ka studiuar në Universitetin George Mason. Sipas "Page Six", unaza me të cilën McVay i propozoi të dashurës kushtoi 100 000 dollarë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisim Prerja

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Tri medalje në Lojërat Evropiane, sukses i madh për Kosovën

Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe trajneri Driton Kuka janë rikthyer në Kosovë me medalje nga Lojërat Evropiane, kurse kanë konfirmuar se medaljet i synojnë edhe në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". "Është një pikënisje e fuqishme për cakun tonë, që janë Lojërat Olimpike 'Tokyo 2020'", ka thënë Driton Kuka

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Dy xhudistet që fituan medalje në Lojërat Evropiane "Minisk 2019", Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova, janë rikthyer të martën në mesditë në Kosovë së bashku me trajnerin Driton Kuka. Në orët e vona janë rikthyer edhe kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Driton Kuka, fituesja e medaljes së tretë (të bronztë), Loriana Kuka dhe xhudisti Akil Gjakova.
Fituesja e medaljes së artë në "Minks 2019", Majlinda Kelmendi, në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" ka thënë se është shumë e lumtur që është rikthyer në formën më të mirë dhe se e ka fituar medaljen e parë në Lojërat Evropiane. "Jam mjaft e lumtur. Është një medalje e cila më ka munguar. Më gëzon jashtëzakonisht fakti që jam bërë e para në këtë garë. Nuk kam garuar gjatë në kampionat. Ky fakt e rrit vetëbesimin tim. Jam gati ta vazhdoj karrierën aty ku e kam nisur. Kam qenë jashtë garave për 14 muaj. Ishte një periudhë e vështirë. Lëndimi është pjesa më e vështirë e sportistit. Fatmirësisht, jam rikthyer shumë mirë, në secilën garë kam marrë medalje. Kjo po tregon se jam kthyer në formën që kam qenë", ka thënë Kelmendi.



Xhudistja tjetër, Nora Gjakova, që e fitoi medaljen e argjendtë, ka thënë se synimi i saj ka qenë ta fitojë medaljen e artë, por edhe me medaljen e fituar është e kënaqur. "Gjithmonë është ndjenjë shumë e mirë dhe kënaqësi me qenë në podium, e sidomos në një garë të këtij niveli. Dëshira ime ka qenë medalja e artë, por jam e kënaqur që gjithçka ka shkuar në rregull. Humba sepse bëra një gabim jo pse kundërshtarja ishte më e mirë. Synimi im është 'Tokio 2020'", ka deklaruar Gjakova.
Shumë i kënaqur me suksesin e arritur në Bjellorusi është trajneri Driton Kuka. Ai ka thënë se tri medaljet e fituara janë një sukses i madh për ekipin e xhudos së Kosovës, kurse me këtë rast konfirmoi se Kosova ka synime të mëdha edhe në Lojërat Olimpike "Tokyo 2020". "Ishte performancë e shkëlqyeshme. Fituam tri medalje. Majlinda u rikthye fuqishëm. Fitoi medalje. Emocion i veçantë për mua ishte medalja e parë për mbesën time. Më ka sjellë emocion. Është vajza e vëllait. Ia kam dëshmuar vëllait që jam më i mirë se ai si trajner, edhe pse dikur ai ka qenë trajner imi. Tri medalje është sukses i madh. Do të ishte shumë nëse do t'i kërkonim katër. Është një pikënisje e fuqishme për cakun tonë, që janë Lojërat Olimpike 'Tokyo 2020'", ka thënë Kuka.

# Ejupi: Nëse nuk miratohet Ligji për Sponsorim do të ketë protesta

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Klubi i Futbollit FC Prishtina vlerëson se është çasti i fundit që deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i thërrasin mendjes dhe ditën e enjte të reflektojnë pozitivisht për miratimin e Ligjit për Korporata. Nga viti 2016 kur është nisur ky debat, është e habitshme dhe e çuditshme se si është neglizhuar deri tani. FC Prishtina kërkon që ky Ligj për Korporata sa më shpejt të harmonizohet me Ligjin për Sponsorim që bien ndesh apo kanë paqartësi ndërmjet vete. Klubi kryeqytetas ka ftuar grupet parlamentare ta gjejnë konsensusin e duhur dhe mos të barrikadohen mbrapa politikave ditore dhe mos të provojnë të gjejnë justifikime të cilat nuk qëndrojnë. Në rast se ndodh mosmiratimi i këtij harmonizimi të ligjeve, e të cilat janë jetike për sportin, kulturën dhe rininë, atëherë sportistët, klubet dhe sidomos njerëzit që e mbajnë sportin, nuk do t'u mbetet tjetër përveç të iniciojnë protesta masive të punëtorëve sportivë, sportistëve, familjarëve të sportistëve, tifozëve dhe të gjithë sport-



dashësve në vend. Gjithnjë sipas Klubit të Futbollit Prishtina, është koha e fundit që ligjbërësit ta kuptojnë se miratimi i këtij harmonizimi do të thotë largim i fëmijëve nga rruga, profesionalizëm dhe investime të reja në sport.
Të gjithë ata deputetë që janë kundër duhet të kenë parasysh që në kohët më të vështira, në paralelizmin nën okupim, sporti ka qëndruar duke zhvilluar gara në kushte më të vështira të mundshme e duke rezistuar e mos lëshuar vendin siç, ndoshta, nuk ka ndodhur, fatkeqësisht, me shumë deputetë. Vetëm pas luftës dhe deri me tani vetëm në futbollin e Kosovës janë shpenzuar mbi 50 milionë euro duke mos pasur asnjë lloj interesi për njerëzit të cilët kanë dhënë shuma të jashtëzakonshme duke e mbajtur futbollin, sportin dhe kulturën. "Nuk dua të besoj s'e ka deputetë që janë kundër sportit. Besoj se nuk kanë pasur informata të mjaftueshme. Por, nëse ndodh që ka të tillë, atëherë ju premtoj se do të gjejmë rrugë për reagim të ashpër prej protestave masive në rrugë e deri në ndalimin e përcjelljes nëpër ndeshje të këtyre deputetëve. Pa financim nuk mund të mbahet sporti. Imagjinojeni sikur vëllezërit Xhaka apo Shaqiri të qëndronin në Kosovë, se a do të arrinin kaq larg sa kanë arritur nëpërmjet shteteve perëndimore ku me ligje adekuate është rregulluar mbajtja e sportit. Shpresoj shumë që të enjten të harmonizohen këto ligje jetike e që për model ka shtetin gjerman me 30 % nga tatimi në fitim, që të hapen mundësitë e investimeve të shumta, sidomos në infrastrukturën sportive, aty ku është baza apo çerdhja e edukimit profesional sportiv", ka thënë Remzi Ejupi, kryetar i FC Prishtina.

## Agim Cana nuk ka dhënë dorëheqje

GJAKOVË, 25 QERSHOR - KF Vëllaznimi nga Gjakova ka mohuar zërat se Agim Cana ka dhënë dorëheqje nga posti i kryetarit të klubit kuqezi. "Njoftojmë opinionin, se informata e botuar në portale, kinse presidenti i Vëllaznimit, Agim Cana, ka dhënë dorëheqje, nuk qëndron. Agim Cana aktualisht është në pushim vjetor, por vazhdon ta ushtrojë detyrën e presidentit të klubit së bashku me kryesinë aktuale. Të përforcuar edhe me anëtarë të ri të kryesisë do të angazhohen që Vëllaznimin ta rikthejnë në Superligë si në edicionin 2020/2021", thuhet në njoftimin e KF Vëllaznimi.
Agim Cana është dënuar nga Federata e Futbollit e Kosovës me gjashtë muaj ndalesë të kryerjes së funksionit zyrtar në klub për të gjitha ndeshjet e organizuara nga ana e FFK-së.



## Santa Coloma kualifikohet në finale

Prishtinë, 25 qershor - Skuadra kampione e Andorrës, FC Santa Coloma, është finalista e parë e turneut parakualifikues për Ligën e Kampionëve që po zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Në ndeshjen gjysmëfinale, kampionët e Andorrës e kanë mundur skuadrën kampione të San Marinos, Tre Penne, me rezultat të ngushtë 1:0. Golin e fitores për skuadrën nga Andorra e realizoi Javier Lopez në minutën e 76 të takimit. Finalja zhvillohet të premten në orën 20:45, në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse skuadra fituese do të kalojë tutje në rrethin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve.

## Rahoveci aplikon në FIBA Europe Cup

RAHOVEC, 25 QERSHOR - Nënkampioni i Kosovës në Basketboll, Rahoveci, edhe zyrtarisht ka aplikuar për të garuar në FIBA Europe Cup. 'Vreshtarët' kishin aplikuar edhe për Basketball Champions League, por meqenëse nuk do të jenë pjesë e kësaj gare, tashmë ata kanë paraqitur zyrtarisht kërkesën për të garuar në FIBA Europe Cup. Kjo do të ishte pjesëmarrja e tyre e parë në garat evropiane. Në edicionin e kaluar Rahoveci ishte nënkampion i Kosovës, derisa kishte organizuar edhe Kupën e Kosovës në basketboll, duke arritur deri në finale, si dhe inauguroi palestrën, ku punimet kishin zgjatur më shumë se një dekadë. Z Mobile Prishtina në edicionin e kaluar kishte arritur në mesin e 16 skuadrave më të mirë të FIBA Europe Cupës.



# Reja: Ndaj Turqisë do të luhet për gjithçka

TIRANË, 25 QERSHOR - Trajneri i Kombëtares Shqiptare, Edi Reja, në një intervistë të dhënë për të përditshmen italiane "Gazetta Dello Sport", ka dhënë opinionin e tij rreth aventurës kuqezi, gjendjes së ekipit dhe shanseve që ka për t'u kualifikuar në Evropian. Intervista e trajnerit nis me një analizë të shkurtër për dy sfidat e tij të para zyrtare në krye të stolit kuqezi. Sa i përket ndeshjes me Islandën, reja është shprehur: "Skuadra nuk e meritonte humbjen, pasi kundërshtari mundi të bënte vetëm një gjuajtje në portë, ndërsa ndaj Moldavisë, rigjetëm krenarinë dhe besimin te vetja. Tifozët prej kohësh nuk e kishin parë ekipin të bënte një lojë të tillë".



Më tej Edi Reja është shprehur se ofertat ndaj tij në Itali nuk kanë munguar madje, pas aventurës së tij tek Atalanta, i është propozuar stoli i Udineses, Beneventos dhe Veronës, por dëshira e tij është që ta mbyllë karrierën në nivel kombëtareje, teksa shtoi se: "Në momentin kur presidenti Duka më ka telefonuar e kam pranuar menjëherë ofertën". Por sa janë shanset që kuqezinjtë të kualifikohen në Evropian? Tekniku 73-vjeçar është shprehur se pas përfundimit të kualifikueseve ekzistojnë mundësitë që bashkëpunimi të vazhdojë. "Ndaj Turqisë do të luhet për gjithçka", ka thënë Reja, i cili ka zbuluar se ka pasur edhe një telefonatë me kryeministrin Edi Rama, me këtë të fundit që është përpjekur ta bindë që të drejtojë Shqipërinë.

Për Tiranën, Reja shprehet se është një qytet i madh, i cili çdo ditë zhvillohet, ndërsa shqiptarët i cilëson si njerëz që e kanë pasion futbollin dhe i kujtojnë Napolin. Në fund Reja ka folur edhe për Berishën, për të cilin është shprehur se këtë sezon ka bërë disa gabime që e kanë penalizuar, por duke qenë se Strakosha është i dëmtuar dhe do të qëndrojë jashtë për një kohë të gjatë jashtë, do të jetë Berisha titullar.

# Barty shkruan historinë, e para në renditjen botërore

CANBERRA, 25 QERSHOR - Tenistja australiane Ashleigh Barty ka shkruar historinë, duke u ngjitur për herë të parë në karrierë në krye të renditjes botërore për femra. Triumfi në Roland Garros dy javë më parë dhe ai në Birmingham fundjavën e kaluar, i kanë dhënë tenistes australiane kreun e renditjes botërore, me 6 540 pikë. 23-vjeçarja australiane rikthen vendin e saj në krye të renditjes botërore pas 43 vjetësh që nga koha e Evonne Cawley. Bie nga froni tenistja japoneze Naomi Osaka, e dyta me 170 pikë më pak. Te meshkujt nuk ka ndryshime, teksa në krye qëndron serbi Novak Djokoviq, me 12 145 pikë, i shkëputur ndjeshëm nga ndjekësit (mbi 4 000 pikë ndaj Nadalit, i dyti). Pesë të parët te meshkujt nuk kanë ndryshme, me Federerin në vendin e tretë, që ndiqet nga Thiem e Zverev.



**RENDITJA, "TOP-5" MESHKUJ**

| | |
|---|---|
| 1. Novak Djokoviq | 12.145 pikë |
| 2. Rafael Nadal | 7.945 pikë |
| 3. Roger Federer | 6.620 pikë |
| 4. Dominic Thiem | 4.595 pikë |
| 5. Alexander Zverev | 4.405 pikë |

**RENDITJA, "TOP-5" FEMRA**

| | |
|---|---|
| 1. Ashleigh Barty | 6.540 pikë |
| 2. Naomi Osaka | 6.377 pikë |
| 3. Karolina Pliskova | 5.685 pikë |
| 4. Kiki Bertens | 5.425 pikë |
| 5. Angelique Kerber | 4.685 pikë |

## SHKURT

### Greca përforcon Gjilanin

Skuadra e Gjilanit ka arritur marrëveshje me sulmuesin e krahut nga Tirana, Bedri Greca. 28-vjeçari i bashkohet Gjilanit nga skuadra e Tiranës, kurse ka qenë pjesë edhe e Flamurtarit, Kukësit dhe Luftëtarit. "Greca në skuadrën e Gjilanit bëhet transferimi i gjashtë në këtë afat kalimtar. Gjithashtu, bordi drejtues i skuadrës po punon me mjaft intensitet për të sjellë edhe përforcime të tjera në kampin kuq e bardhë, ku po synohet të ndërtohet një ekip konkurrues për edicionet e radhës në Superligën e Kosovës në futboll", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

### Zeneli operohet me sukses

Arbër Zeneli ka njoftuar në "Instagram" se është operuar me sukses në gju, pas lëndimit të rëndë që e pësoi në fillim të këtij muaji në një ndeshje me Përfaqësuesen e Kosovës, dhe u zotua se do të rikthehet edhe më i fuqishëm. Anësori i Stade de Reims u detyrua ta braktisi lojën në fillim të pjesës së dytë në barazimin e Kosovës 1-1 me Malin e Zi në një ndeshje kualifikuese për Kampionatin Evropian 2020, pasi e pësoi një dëmtim të rëndë në gju. 24-vjeçari është operuar me sukses në lëndimin e gjurit të djathtë që pritet ta lërë atë jashtë fushës së futbollit shtatë deri nëntë muaj.

### Griezmanni në korrik prezantohet te Barcelona

Barcelona duket se e ka mbyllur gjithçka për blerjen e parë të kësaj merkatoje. Katalanasit do të shpenzojnë plot 120 milionë euro për të sjellë në "Camp Nou" Antoine Griezmann. Diçka të tillë e ka raportuar edhe "Telegraph" që shkruan se gjithçka është e kryer dhe se transferimi do të finalizohet në ditët e para të korrikut. Kështu, duket se merr fund edhe telenovela "Griezmann", i cili prej kohësh kishte deklaruar largimin nga Atletico Madridi.

### Pogba refuzon Realin

Mesfushori i Francës, Paul Pogba, preferon rikthimin në Juventus, para transferimit në Real Madrid gjatë këtij afati kalimtar të verës. E përditshmja sportive madrilene "AS" shkruan se Zinedine Zidane do të mbetet pa e transferuar mesfushorin francez i cili ka vendosur të largohet nga Manchester Unitedi. 26-vjeçari ka vendosur të gjejë një ekip të ri pas një sezoni dëshpërues në "Old Trafford". Por, ai preferon rikthimin te "Bianconerët" para transferimit te skuadra nga "Santiago Bernabeu".

### Di Biagio largohet nga Italia

Luigi Di Biagio nuk është më trajner i skuadrës nën 21 vjeç të Italisë. Barazimi 0-0 i Francës me Rumaninë solli eliminimin e Italisë nga Evropiani i këtij viti, teksa "Azurret" shpresonin për ta fituar trofeun, duke parë lojtarët që kishin në skuadër, mjafton të përmendim emra si: Chiesa, Barrela, Kean, Zaniolo, Cutrone, Orsolini, Dimarco apo Tonali. "Duhet t'i ndajmë rezultatet që kemi arritur në këto vite, nga ajo që ndodhi në Evropian. Kemi bërë punë të madhe, kemi rritur shumë lojtarë, jemi përballur me skuadra të forta dhe kemi përgatitur shumë lojtarë për kombëtaren A. Rezultati nuk është pozitiv, por për mua nuk është një dështim. Unë nuk do të jem më trajner i përfaqësueses U-21", ka thënë Di Biagio.



Autor: GAZMEND MORINA

- AKTORI AMERIKAN STILLER
- JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË
- JEVG
- IVAN KLASNIÇ
- KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA
- KRYENGRITË-SI QË DILTE MALIT E LUFTONTE / MINDERI I ULËT (vjet.)
- IVREA
- BIMË SHUMËVJE-ÇARE ME TRUNG TË TRASHË
- LLOJ BIME NARKOTIKE
- ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT
- DY BASHKË-TINGËLLORE / DRAMË E SANTORIT
- NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË
- EPOKË (shq.)
- KANUN, LIGJ (vjet.)
- AKTROJA AMERIKANE BASINGER / SHTET I MADH NË AZI
- SEKRETARI I OKB-së BAN KI / QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP (për kafshët)
- BASHKËT. SHPREHET ME FJALË
- GJAKATARI BIXHOZ
- ZANORE / MALI MË I LARTË NË TURQI
- NJERI I VARFËR QË ËSHTË PËR T'U MËSHIRUAR (shq.)
- BANORI I ARABISË SAUDITE / VARGU I KURANIT
- BUJKU / KËNGËTARJA BERISHA
- KËNGËTARJA ...... SEJDIU / ZANORE
- NËNA VEPRIMTARI ZEZAK MARTIN ..... KING
- ANTIGONA SEJDIU / OLIVIER MARTINEZ
- DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR
- I SPËRKATA ME UJË
- BOKSIERI I NJOHUR KLITSCHKO
- "Z" në mes të dy "A"
- PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË
- TEXAS LIBRARY ASSOCIATION / IDRIZ BALAJ
- REGJISORI ... QOSJA
- TËRËSIA E ORENDIVE / SMIRA
- KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)
- PËRGËZIMET / SHTET (FR.)
- MIMOZA AHMETI / AKTORJA ....... AJETI
- AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS
- AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE NË FOTO ........ OLSEN (shqip.)
- KËNGËTARI ..... ARIFI / ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN
- TONI ADAMS / QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE
- KËSTET BANKARE PËR KTHIMIN E KREDISË
- GRADË USHTARAKE / QË KA TË BËJË ME FSHATIN
- REGJISORI .... HALILI / PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE
- KOHA E NDARË PËR PUNË / POLITIKANI FERID .....
- JETËSHKRIM / ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (origj.)
- ARMENIA UNITED PROGRESIVE ALLIANCE
- SHIU I IMËT / DALLGA
- UMA TURMAN / AKTORI EGJIPTIAN .... SHARIF
- BISHTUK ME VAJGURI (shq.) / QË KA MBUSHUR NJË VIT, MOTAK
- PRAPË
- ARTANA
- ISH MUZIKANTI RUS STRAVINSKI / GDHENDUR, LATUAR
- PYLLI / PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)
- I ÇELA / ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER
- DY BASHKË-TINGËLLORE
- FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit. greke) / POROSIA E FUNDIT
- MA JEP / INSTITUCION I LARTTË SHKENCOR
- AGIM POSHKA / KALI I SHALËS
- HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) / LLOJ SHALE DRURI
- ANIJATA / HARAÇ
- ZANORE / ALBANOLOGIA DURHAM
- FUTBOLLISTI FRANCEZ ..... NASRI (MANCHESTER CITY)
- SHEGË / LUMË NË SHQIPËRI
- BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT / SHEJTAN
- ALUMIN, AMPER
- KLUB FUTBOLLI NË GREQI
- PAJISJA E VETURËS SË LËSHON TINGUJ / REOMIR, INDIUM
- OSAKA / RROGË VJETORE E PAPËS
- IVAN DIXON / QË I PËRKET ETIKËS
- BALTA E QULLËT, GJANA
- KULLË E XHAMISË
- SHKRIMTARI ISMAIL / STUDENT AID REPORT
- IGLESIAS GABRIEL / NJËSI E VJETËR PESHE
- ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË
- ELEMENT KIMIK (SE)
- FUTBOLLISTI FRANÇESKO (ROMA) / TITAN
- PUNA E PËRDITSHME, ZAKONISHT E MËRZITSHME, PA ASNJË NDRYSHIM
- ATEMOR, JO TEMATIK / ZANORE
- BASHKËT. KRUJA
- REGJISORJA .... ELEZI
- HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE
- LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Tempohousing Kosovo” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810863870 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

---

### OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka “Tempohousing Kosovo” L.L.C doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810863870 I ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

---

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company “Tempohousing Kosovo” L.L.C, has come to the decision to quit its business with registry 810863870 -The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “ALP FRESH” SH.P.K ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810157520 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

---

### OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka “ALP FRESH” L.L.C doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810157520 I ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

---

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company “ALP FRESH” L.L.C, has come to the decision to quit its business with registry 810157520 -The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Shuarja e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “EXTRA-LAB”, me seli në Prishtinë, me NRB.71310604, dhe me nr TVSH-së 330331885. Konform nenit 112 , paragrafi 1 te Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, themeluesi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “EXTRA-LAB” zonj. Shukrije Kaqanolli me numër të ID 1233657189 nga fshati Bradash, Komuna e Podujevës , me vendbanim të përhershëm në Prishtine, Rruga : ”Ibrahim Kelmendi” pa nr. Drejtor i Shoqërisë me 100% të aksioneve në , “EXTRA-LAB” Sh.P.K,

Shpalle të mbyllur /shuar Shoqërinë “EXTRA-LAB” dhe kërkojnë nga kreditoret që pretendojnë të kenë ndonjë kerkes nga “ALIDESKO” Shpk, në afate prej 30 ditësh të paraqesin kërkesat e tyre për ekzekutim.

### OBAVESTENJE

Izručenje društva sa ograničenom odgovornošću "EXTRA-LAB", sa sedištem u Prištini, sa NRB.71310604, i sa NTVSh 330331885. Prema članu 112, stav 1 Zakona br. 06 / L-016 o poslovnim organizacijama, osnivač kompanije sa ograničenom odgovornošću "EXTRA-LAB" Ms. Shukrije Kaqanolli sa identifikacionim brojem: 1233657189 iz Bradash-a, Opština Podujevo, sa stalnim prebivalištem u Prištini, Ulica: "Ibrahim Kelmendi" br. Direktor kompanije sa 100% udela u "EXTRA-LAB" Shpk,

Objasniti zatvoreno / ugaseno preduzeće "EXTRA-LAB" i zatražiti od povjerilaca koji tvrde da imaju bilo kakav zahtjev od "EXTRA LAB" Shpk, u roku od 30 dana da dostave svoja izvršenja na izvršenje.

### NOTICE

Extradition of the Limited Liability Company "EXTRA-LAB", ëith headquarters in Prishtina, ëith NRB.71310604, and ëith NTVSh 330331885. According to Section 112, paragraph 1 of Laë No. 06 / L-016 on Business Organizations, the founder of the company ëith limited liability "EXTRA-LAB" Ms. Shukrije Kaqanolli ëith ID number: 1233657189 from Bradash, Municipality of Podujevë / Podujevo, ëith permanent residence in Prishtina, Street: "Ibrahim Kelmendi" no. Director of the Company ëith 100% stake in "EXTRA-LAB" Shpk,

Explain closed / extinguished the "EXTRA-LAB" Company and request from the creditors claiming to have any claim from "EXTRA LAB" Shpk, in the capacity of 30 days to submit their executions for execution.



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

**Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë**
**Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije**
**Ministry of Education, Science and Technology**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212-Gazeta zyrtare nr. 90/1 dhjetor 2010), UA-26/2013, zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet e arsimit parauniversitar, UA- 34/2014-Funksionimi i Këshillit pedagogjik- psikologjik në shkolla :

## Shpall konkurs për "Psikologë dhe pedagogë"

**Institucioni:** *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë*

**Titulli i vendit të punës:**
**Psikologë dhe pedagogë në institucionet edukativo-arsimore;**

**Vendi i punës sipas regjioneve arsimore: Prishtinë 10 (6 psikologë dhe 4 pedagogë), Mitrovicë 5 (3 psikologë dhe 2 pedagogë), Prizren 9 (pesë psikologë dhe katër pedagogë), Ferizaj 8 (pesë psikologë dhe tre pedagogë), Pejë, 6 (tre psikologë dhe tre pedagogë) Gjilan, 6 ( katër psikologë dhe dy pedagogë) Gjakovë, 6 (katër psikologë dhe dy pedagogë)**

**Datë: 25.06.2019**

**Detyrat e pedagogëve:**

- Planifikimin, programin dhe organizimin e punës edukative - arsimore
- Mbështetjen e hartimit dhe zbatimit të planit zhvillimor të shkollës
- Koordinimin e punës së aktiveve personale, planprogramin e mësimdhënësve
- Përkrahjen e klubeve të nxënësve, këshillat e prindërve dhe organet apo këshillat e tjera të shkollës
- Merr pjesë në hulumtimin e nevojave arsimore, në hartimin dhe zbatimin e projekteve shkollore
- Përcjellë dhe inkurajon futjen e risive dhe praktikave të mira pedagogjike
- Pedagogu vepron në realizim të efektshëm të procesit edukativo-arsimor
- Pedagogu ndihmon dhe udhëzon mësimdhënësit në zbatimin e metodologjive ndërvepruese të mësimdhënies duke promovuar filozofinë me nxënësin në qendër përmes ndihmës për implementimin e nxënies në bashkëpunim me mësimdhënësit duke i ndihmuar ata në përgatitjen e modeleve arsimore, planeve ditore dhe aspekteve të tjera të veprimtarisë arsimore.

**Detyrat e psikologëve:**

- Psikologu bashkëpunon me pedagogun e shkollës në të gjitha çështjet e përbashkëta të këtyre dy profesioneve
- Psikologu ka detyrë të kontribuojë në lehtësimin e procesit të të nxënit dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësit
- Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë
- Psikologu punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënit, zhvillimit social e personal të nxënësit
- Psikologu bashkëpunon me mësimdhënës, prindër dhe komunitetin
- Psikologu afron konsultime me mësimdhënës, prindër dhe komunitetin me qëllim të shëndetit sa më ë mirë të nxënësve
- Psikologu bashkëpunon me institucione profesionale të shkollës, institucione të tjera sociale dhe shëndetësore dhe organizata të tjera me qëllim të përvetësimit të praktikave të mira.

***Kualifikimet dhe kushtet në vendin e punës:***

1. Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në sistemin arsimor
2. Psikologët të kenë përgatitje shkollore të nivelit master në Fakultetin Filozofik, degën e Psikologjisë- drejtimi: Psikologji shkollore dhe Këshillim, të fakultetit filozofik ( apo siç është rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional)
3. Pedagogët të kenë përgatitje shkollore të nivelit master në degën e Pedagogjisë përkatësisht Fakultetin e Edukimit, studimet katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë apo siç është e rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional)
4. Njohuri dhe përvojë për sistemin arsimor
5. Përvojë në zhvillimin e programeve dhe këshillimit
6. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit
7. Shkathtësi këshillimi, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
8. Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
9. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit **16.07.2019**

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në uebfaqen e MASHT-it **http://masht.rks-gov.net/**, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, adresa: Rr. "Agim Ramadani" p.n. në zyrën 4, në arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuara.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Diplomat duhet të jenë të noterizuara.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



**C.nr.586/14**

**GJYKATA THEMLORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditesit Xhabir Jashari nga fshati Begaj, Vushtrri, kundër të paditurit Sllobodan Gjurkovic, nga fshati Gojbulë, Komuna e Vushtrrisë, tani me adresë të pa njohur, lidhur me vërtetim pronësie, me datën 24.06.2019, mori këtë:

**AKTVENDIM**

**I.CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm av.Namon Merovci nga regjioni i Mitrovicës për t'i ushtruar të gjitha të drejta dhe detyrat për të paditurin Sllobodan Gjurkovic, deri sa të paraqitet i njëjti në gjykatë apo përfaqësuesi i tij me prokurë.
**II.**Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarr të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurit, deri në momentin kur i padituri të paraqitet në gjykatë personalisht, të caktoj të autorizuarin e saj apo deri në momentin kur organi kujdestarisë-QPS ne Vushtrri ti caktoj kujdestarin.
**III.**Seanca e radhës caktohet për datën **23.07.2019 ne ora 10,00** dhe ky komunikim palëve ju shërben ne vende te thirrjes se rregullt.
**IV.**Ky aktvendim do te publikohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljes të kësaj gjykate, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, paditësit dhe organit të kujdestarisë.

**Arsyetim**

Paditësi Xhabir Jashari pranë kësaj gjykate me datën 09.12.2014, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit Sllobodan Gjurkovic, nga fshati Gojbulë, Komuna e Vushtrrisë, tani me adresë të pa njohur, lidhur me vërtetim pronësie.
Gjykata lidhur me këtë çështje juridike ka caktuar seancën gjyqësore me datën 24.06.2019, për të cilën seancë ka provuar ta ftoj të paditurin Sllobodan Gjurkovic, me adresë si në padi, por nga fletë kthesa është konstatuar pala është e pa njohur.
Mbi këto arsye dhe sipas propozimit te palës paditëse, gjykata ka vendosur që të paditurit ti caktoj përfaqësuesin e përkohshëm nga radhët e avokateve pasi që i njëjti me vendbanim dhe vendqëndrim është i panjohur, ndërsa Oda e Avokateve te Kosoves, e ka bërë përzgjedhjen e avokatit Namon Merovci nga regjioni i Mitrovicës.
Nga sa u pa le marte e duke u bazuar ne vështrim te nenit 79, 81, 82 dhe 83 te LPK-së u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**
**Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil**
**C.nr.586/14, datë: 24.06.2019**

**GJYQTARI**
**Izet Gërguri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **" BIOVET " SH.P.K**. me seli në Leshan – Suharekë, ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit 71195791 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillim të procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavamo sve klijente da Tvrtka **" BIOVET " SH.P.K**. sa sedistem u Lesane-Suvareka, donijelo odluku da ugasi biznis po broju registra 71195791. Ujedno imenovao likvidatora o sprovodjenju postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju izvestaje o kreditu-duzniku u ovoj kompaniju obavestavaju se u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **" BIOVET " SH.P.K**. in Leshan-Suhareka, has come to the decision to quit its business with registry number 71195791. The Company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgages-mortgage accounts in this Company are kindly request to show up within 30 days starting from the day newspaperannouncementy publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Gipa" Sh.p.k Kramovik, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin dhe thërrmimin e rërës dhe zhavorrit në Kramovik komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.07.2019 në ora 11:30 në zyrat e kompanisë "Gipa" Sh.p.k Kramovik, Rahovec do të organizohet debat publik nga kompania "Gipa" Sh.p.k Kramovik, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin dhe thërrmimin e rërës dhe zhavorrit në Kramovik komuna e Rahovecit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **" PROBIOVET " SH.P.K**. me seli në Leshan – Suharekë, ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit 71202593 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillim të procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavamo sve klijente da Tvrtka **" PROBIOVET " SH.P.K**. sa sedistem u Lesane-Suvareka, donijelo odluku da ugasi biznis po broju registra 71202593. Ujedno imenovao likvidatora o sprovodjenju postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju izvestaje o kreditu-duzniku u ovoj kompaniju obavestavaju se u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **" PROBIOVET " SH.P.K**. in Leshan-Suhareka, has come to the decision to quit its business with registry number 71202593. The Company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgages-mortgage accounts in this Company are kindly request to show up within 30 days starting from the day newspaperannouncementy publication.

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**
**FAKULTETI JURIDIK**

Studimet Postdiplomike të Doktoratës

Prishtinë, 25.06.2019

Në bazë të nenit 127 al.1, të statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nenit 17 al. 2 dhe 4, të rregullores mbi studimet e doktorates, Vendimit nr. 02/89, nga Mbledhja e Këshillit të Fakultetit Juridik, të datës 12.04.2019, si dhe vendimit për ratifikimin, nga Senati i UP, datë 12.06.2019, kandidatit Ma.sc. Artan Fejzullahu i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të cekura më lartë, bëjmë këtë:

**N J O F T I M**

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit, se me datën 05/07/2019, me fillim në ora 14:30, në Amfiteatrin e Madh të Fakultetit Juridik, kandidati për fitimin e titullit doktor i shkencave juridike, nga fusha: Kushtetuese – Administrative, Artan Fejzullahu bën mbrojtjen publike të disertacionit me titull: *"Sfidat dhe problemet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetrore në Republikën e Kosovës",nën mentorimin e Prof Dr. Mirlinda Batalli,* para komisionit profesional, me këtë përbërje:

1. Prof.Dr. Arsim Bajrami (Kryetar)
2. Prof.Ass.Dr. Murat Jashari (anëtar)
3. Prof.Asoc. Dr. Sadik Haxhiu (anëtar i jashtëm, nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Gjilanit)

Prishtinë, më 25.06.2019

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Ergini Company" Sh.p.k. Muçivërc, Kamenicë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e reres dhe zhavorit në Muçivërc, Kamenicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.07.2019 në ora 11:00 në restorantin "Oda"në Hodonovc kommuna e Kamenicës, do të organizohet debat publik nga kompania kompania "Ergini Company" Sh.p.k. Muçivërc, Kamenicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e reres dhe zhavorit në Muçivërc, Kamenicë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**
**FAKULTETI JURIDIK**

Studimet Postdiplomike të Doktoratës

Prishtinë, 25.06.2019

Në bazë të nenit 127 al.1, të statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nenit 17 al. 2 dhe 4, të rregullores mbi studimet e doktorates, Vendimit nr. 02/89, nga Mbledhja e Këshillit të Fakultetit Juridik, të datës 12.04.2019, si dhe vendimit për ratifikimin, nga Senati i UP, datë 12.06.2019, kandidatit Ma.sc. Artan Fejzullahu i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të cekura më lartë, bëjmë këtë:

**N J O F T I M**

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit, se me datën 05/07/2019, me fillim në ora 14:30, në Amfiteatrin e Madh të Fakultetit Juridik, kandidati për fitimin e titullit doktor i shkencave juridike, nga fusha: Kushtetuese – Administrative, Artan Fejzullahu bën mbrojtjen publike të disertacionit me titull: *"Sfidat dhe problemet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetrore në Republikën e Kosovës",nën mentorimin e Prof Dr. Mirlinda Batalli,* para komisionit profesional, me këtë përbërje:

1. Prof.Dr. Arsim Bajrami (Kryetar)
2. Prof.Ass.Dr. Murat Jashari (anëtar)
3. Prof.Asoc. Dr. Sadik Haxhiu (anëtar i jashtëm, nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Gjilanit)

Prishtinë, më 25.06.2019

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

## Ramadan Hasani shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 80558325 me emër të biznesit DTP "Endriti" me seli në Likovc.

▶ Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "EXTRA-LAB", me seli ne Prishtinë, me NRB.71310604, shpall të pavlefshme Certifikatën e TVSH -se, nr. 330331885, drejtori Shukrije Kaqanolli.

▶ Dijana Selmani shpallë të pavlefshme Diplomën e SH.M.L.E.J "Hoxh Kadri Prishtina" të vitit 89/90.

▶ N.SH. "Klinika Dentare Suedeze" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70986698.

▶ "Auto Taxi" Vehbi Alija shpallë të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 70248432 dhe nr. fis. 600321114.

▶ Atdhe Gajtani shpallë të pavlefshme Diplomën e Shkollës së Mesme "Gjin Gazulli", në Prishtinë.

▶ Liridona Haxhijaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.

▶ Shpëtim Ahmetaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës "Loyola Gimnasium" në Prizren.

▶ Fisnik Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "2 Dëshmorët" - Piranë.

▶ "DPT Loni-Gas", shpallë të pavlefshme certifikatën e regjistrimit te biznesit ne numër:70550253 dhe numër fiskal: 600045464.

▶ Leart Muja shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Ali Ajgeraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Fadil Hisari" Prizren.

▶ Rashid Imrihor shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VI shf "Matilo Goreci" Prizren.

▶ Valdet Xhakolaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Pjeter Budi" Lubizhd Has.

▶ Bashkim Karaqeva shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Sabahate Ukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Romajë.

▶ Sami Fetahi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Hysni Temaj" Kushnin.

▶ Mendim Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Ibrahim Fehmiu" Arbanë.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të këtë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L